



Sfidat dhe këndvështrimet e të rinjve në Kosovë



Janar 2021

Sfidat dhe këndvështrimet e të rinjve në Kosovë

**Studimi është
kontraktuar UNDP
në Kosovë**

Prishtinë
Janar 2021

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të pjesëmarrësve të anketës dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e UNDP-së

Tabela e përmbajtjes

| | | |
|----------|--|-----------|
| 1 | Përmbledhje ekzekutive | 9 |
| 2 | Hyrje dhe sfondi | 13 |
| 3 | Metodologjia | 15 |
| | Komponenti sasior | 15 |
| | Komponenti cilësor | 16 |
| 4 | Rezultatet | 17 |
| | Përbërja demografike | 17 |
| | Çështjet brengosëse për rininë e Kosovës | 18 |
| | Qasja në arsim | 29 |
| | Tranzicioni në punësim | 38 |
| | Çështjet ndër-etnike, fetare dhe të sigurisë | 48 |
| | Pritjet për të ardhmen | 60 |
| 5 | Konkluzionet dhe rekomandimet | 64 |
| 6 | Referencat | 68 |
| 7 | ANEKS | 70 |

Lista e akronimeve

| | |
|-----------------|---|
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| CATI | Intervistimi Telefonik i Asistuar nga Kompjuteri |
| KE | Komisioni Evropian |
| FES | Fondacioni Friedrich-Ebert |
| GF | Grup i fokusit |
| NEET | Jo në arsim, punësim, aftësim |
| OJQ | Organizatë jo-qeveritare |
| OECD | Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik |
| PBF | Fondi për Ndërtim të Paqes i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së |
| PP | Pikë përqindje |
| UNDP | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| UNICEF | Fondi Ndërkombëtar i Kombeve Bashkuara për Emergjencat e Fëmijëve |
| UNKT | Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë |
| UNV | Vullnetarët e Kombeve të Bashkuara |
| UN WOMEN | Entiteti i Kombeve Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave |
| USAID | Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar |

Lista e Figurave

| | |
|---|----|
| Figura 1 Shpërndarja gjinore e të anketuarve | 17 |
| Figura 2 Shpërndarja moshore e të anketuarve | 17 |
| Figura 3 Shpërndarja etnike e të anketuarve | 18 |
| Figura 4 Shpërndarja rajonale e të anketuarve | 18 |
| Figura 5 Statusi civil i të anketuarve mbi 18 vjeç | 18 |
| Figura 6 Shpërndarja rajonale e të anketuarve | 18 |
| Figura 7 Opinioni i të anketuarve nëse Kosova po ecën në drejtimin e duhur | 19 |
| Figura 8 Opinioni i të anketuarve nëse Kosova po ecën në drejtimin e duhur, sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike | 20 |
| Figura 9 Tri sfidat kryesore të të rinjve në Kosovë | 21 |
| Figura 10 Tri sfidat kryesore të të rinjve në Kosovë, sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike | 22 |
| Figura 11 Sjellja e votimit në zgjedhjet lokale dhe kombëtare në Kosovë | 23 |
| Figura 12 Aspekte të rëndësishme në jetën e të rinjve | 24 |
| Figura 13 Shqetësimet personale të të rinjve në Kosovë | 25 |
| Figura 14 Të anketuarit që kishin shokë të përfshirë në sjellje ose përvoja të rrezikshme gjatë 12 muajve të fundit | 26 |
| Figura 15 Përgjigjet e të anketuarve nëse do ta konsiderojnë migrimin brenda tre viteve të ardhshme | 27 |
| Figura 16 Përgjigjet e të anketuarve nëse do ta konsiderojnë migrimin brenda tre viteve të ardhshme | 28 |
| Figura 17 Tri arsyt kryesore për emigrim | 28 |
| Figura 18 Tri arsyt kryesore për emigrimin, sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike | 29 |
| Figura 19 Frekuentimi i shkollës ose universitetit në kohën e intervistës | 29 |
| Figura 20 Frekuentimi i shkollës ose universitetit në kohën e intervistës, sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike | 30 |
| Figura 21 Pajtimi me deklarata në lidhje me përvojat e përfshirjes sociale në shkollë | 30 |
| Figura 22 Aspiratat arsimore të të rinjve | 31 |
| Figura 23 Pengesat ndaj vazhdimit të arsimimit përtej shkollës së mesme | 32 |
| Figura 24 Shkollimi më i lartë i përfunduar | 33 |
| Figura 25 Arsytet e braktisjes së shkollës ose universitetit | 33 |
| Figura 26 Kënaqshmëria me arsimin e lartë të marrë | 33 |
| Figura 27 Kënaqshmëria me arsimin e lartë të marrë, sipas përkatësisë etnike | 34 |
| Figura 28 Dobia e arsimit për gjetjen e një pune | 35 |
| Figura 29 Dobia e arsimit për gjetjen e një pune, sipas moshës | 35 |
| Figura 30 Pengesat kryesore të dëshmuara gjatë arsimimit | 36 |
| Figura 31 Pengesat kryesore të dëshmuara gjatë arsimimit, sipas moshës dhe përkatësisë etnike | 37 |
| Figura 32 Dobia e perceptuar e aftësisimit profesional për të ardhmen e të rinjve | 37 |
| Figura 33 Aktivitetet aktuale të punësimit të të rinjve | 38 |
| Figura 34 Aktivitetet aktuale të punësimit të të rinjve, sipas gjinisë dhe moshës | 34 |
| Figura 35 Arsytet për të mos kërkuar punë | 39 |

| | | |
|-----------|---|----|
| Figura 36 | Arsyet për të mos kërkuar punë, sipas përkatësisë etnike | 40 |
| Figura 37 | Si e mbajnë veten financiarisht të rinjtë e papunë | 41 |
| Figura 38 | Përvoja e punës së të rinjve të papunë | 42 |
| Figura 39 | Arsyet pse nuk punojnë më në punët e mëparshme | 42 |
| Figura 40 | Të papunë që e kanë refuzuar një punë | 42 |
| Figura 41 | Të papunë që do ta konsideronin një punë me të hyra të ulëta | 42 |
| Figura 42 | Kohëzgjatja e kërkimit të punësimit | 43 |
| Figura 43 | Arsyet e vështirësive në sigurimin e punësimit | 43 |
| Figura 44 | Besimi i të anketuarve për gjetjen e një pune në gjashtë muajt e ardhshëm | 44 |
| Figura 45 | Preferenca e sektorit të punës | 44 |
| Figura 46 | Angazhimi në aktivitete të papaguara për të ndihmuar organizatat, klubit, grupet ose komunitetet | 45 |
| Figura 47 | Angazhimi në aktivitete të papaguara për të ndihmuar organizatat, klubit, grupet ose komunitetet, sipas gjinisë dhe moshës | 45 |
| Figura 48 | Angazhimi në aktivitete të papaguara për të ndihmuar organizatat, klubit, grupet ose komunitetet, sipas përkatësisë etnike | 46 |
| Figura 49 | Lloji i vendit të punës të të anketuarve të punësuar | 46 |
| Figura 50 | Sfidat ndaj gjetjes së punës | 47 |
| Figura 51 | Sfidat ndaj gjetjes së punës, sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike | 47 |
| Figura 52 | Vlerësimi i marrëdhënieve mes të rinjve shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës | 48 |
| Figura 53 | Vlerësimi i marrëdhënieve mes të rinjve shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës, 2020 kundrejt 2018 | 49 |
| Figura 54 | Baza për vlerësimin e marrëdhënieve ndërmjet të rinjve shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës | 50 |
| Figura 55 | Vlerësimi i marrëdhënieve ndërmjet të rinjve shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës dhe komuniteteve të tjera jo-shumicë | 51 |
| Figura 56 | Arsyet kryesore që kontribuojnë në marrëdhëniet e tensionuara ndërmjet etnive të ndryshme në Kosovë | 52 |
| Figura 57 | Si mund të përmirësohen marrëdhëniet mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës | 52 |
| Figura 58 | Si mund të përmirësohen marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës, sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike | 53 |
| Figura 59 | Praktikimi i fesë | 54 |
| Figura 60 | Pajtimi me pikëpamjet fetare të njerëzve të tjerë | 54 |
| Figura 61 | Ndikimi i komunitetit fetar në zonën e të rinjve | 55 |
| Figura 62 | Perceptimi i të rinjve mbi prevalencën e llojeve të ndryshme të ekstremizmit në Kosovë | 56 |
| Figura 63 | Baza e vlerësimit në lidhje me nivelin e perceptuar të ekstremizmit fetar në Kosovë | 56 |
| Figura 64 | Ndjenja e sigurisë e të rinjve në Kosovë | 57 |
| Figura 65 | Ndjenja e sigurisë e të rinjve në Kosovë, sipas gjinisë | 58 |
| Figura 66 | Perceptimi nëse institucionet e nivelit qendror të Kosovës po bëjnë mjaftueshëm që të rinjtë të ndihen të sigurt në vende të ndryshme | 59 |
| Figura 67 | Gjasat e perceptuara që të rinjtë në Kosovë të kenë një jetë më të mirë pas pesë vjetësh | 60 |
| Figura 68 | Gjasat e perceptuara që të rinjtë në Kosovë të kenë një jetë më të mirë pas pesë vjetësh, sipas gjinisë, moshës | 61 |
| Figura 69 | Gjasat e perceptuara në lidhje me përmirësimin e çështjeve të ndryshme në Kosovë | 62 |

Lista e tabelave

| | |
|---|----|
| Tabela 1. Shpërndarja e mostrës sipas rajonit | 15 |
| Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas përkatësisë etnike | 16 |
| Tabela 3. Sample distribution by age | 16 |
| Tabela 4. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 1, shqiptarë | 70 |
| Tabela 5. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 2, shqiptarë | 70 |
| Tabela 6. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 3, shqiptarë | 71 |
| Tabela 7. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 4, shqiptarë | 71 |
| Tabela 8. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 5, serbë | 71 |
| Tabela 9. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 6, serbë | 72 |
| Tabela 10. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 7, serbë | 72 |
| Tabela 11. Orët për javë të kaluara në aktivitete të ndryshme | 31 |

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Studimi për Rininë në Kosovë 2020 synon të kontribuojë në të kuptuarit e qëndrimeve, këndvështrimeve dhe sfidave kryesore të të rinjve në Kosovë¹ lidhur me temat e migrimit, arsimit, punësimit, marrëdhënieve ndëretnike dhe pikëpamjeve për të ardhmen e Kosovës.² Ky studim është porositur nga UNDP në Kosovë dhe ka për qëllim t'u ofrojë agjencive të UNKT dhe palëve kombëtare dhe ndërkombëtare të interesit informata dhe analiza që mund t'u ndihmojnë të vlerësojnë progresin e bërë në adresimin e çështjeve të të rinjve, të vlerësojnë përpjekjet e kaluara dhe të vazhdueshme, mësimet e nxjerra, dhe të zhvillojnë përgjigjet e politikave. Për këtë qëllim, ky raport ndjek Studimin për Rininë 2018 duke i krahasuar dhe dalluar të dhënat e reja të mbledhura përmes një ankete dhe grupeve të fokusit të realizuar mes nëntorit dhe dhjetorit 2020.

Duhet theksuar se ky studim u krye në fund të një viti të shënuar nga vazhdimi i paqëndrueshmërisë politike në Kosovë në kombinim me ndikimin e **pandemisë Covid-19**. Sfidat e sjella nga pandemia i kanë bërë më të cenueshëm të rinjtë, gratë dhe komunitetet e marginalizuara. Pandemia ka sjellë një emergjencë të jashtëzakonshme duke krijuar trysni shtesë mbi sistemin e kujdesit shëndetësor, si dhe ka përkeqësuar brishtësinë para-ekzistuese të ekonomisë, duke rritur pabarazinë dhe ndarjet sociale. Prandaj, është e rëndësishme që gjetjet e këtij studimi të vendosen në kontekstin e një krize shumëplanëshe dhe të ndikimit të saj në çështjet sociale, arsimore, të punësimit, financiare, mundësive në të ardhmen dhe shqetësimeve të shëndetit mendor për të rejtat dhe të rinjtë në Kosovë.

Ky studim do të fillojë duke prezantuar disa nga gjetjet dhe pikat kryesore, të ndjekura nga një pasqyrë e kontekstit të Kosovës në lidhje me rininë, dhe një përmbledhje e metodologjisë. Pjesa kryesore e këtij punimi do të shqyrtojë në detaje të dhënat mbi çështjet kryesore sociale, ekonomike, të sigurisë dhe politike për të rinjtë kosovarë, dhe këndvështrimet e tyre mbi faktorët kryesorë dhe zgjidhjet për trajtimin e çështjeve në fushat e arsimit, punësimit, fesë, marrëdhënieve ndëretnike dhe sigurisë.

GJETJET KRYESORE

Më shumë se gjysma e të rinjve që u intervistuan mendonin se **Kosova po ecte në drejtimin e gabuar në vitin 2020 (52%)**, një rritje prej 20 pikë përqindjeje (pp) krahasuar me gjetjet e vitit 2018, ndërsa një në katër mendonte se situata në vend ka stagnuar (24%). Për më tepër, **mungesa e mundësive për punë (81%), varfëria ose situata e dobët ekonomike (68%),** dhe **nepotizmi/korrupsioni (42%)** mbeten tre sfidat kryesore për të rinjtë në Kosovë. 20% të tjerë iu referuan situatës së përgjithshme politike dhe 17% përmendën cilësinë e ulët të arsimit. Teksa këto probleme u shprehën si çështjet kryesore edhe në vitin 2018, në vitin 2020 një përqindje e rritur e të rinjve përmendi mungesën e mundësive për punë (një rritje prej 21 pikë përqindje (pp)) dhe varfërinë ose situatën e dobët ekonomike (një rritje prej 19 pp). Në të njëjtën kohë, gjetjet cilësore treguan qartë se pavarësisht nga përkatësia etnike, mosha ose gjinia, pjesëmarrësit e grupeve të fokusit u pajtuan se **papunësia** ishte sfida numër një për të rinjtë në Kosovë, si çështje të spikatura u theksuan edhe mospërputhja mes nevojave të tregut të punës dhe profileve të të diplomuarve të rinj, si dhe nepotizmi në proceset e rekrutimit.

Kompleksiteti dhe ashpërsia e çështjeve me të cilat përballen të rinjtë në Kosovë u reflektuan edhe në

¹Referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

²I referuar edhe si Studimi për Rininë gjatë gjithë raportit.

gjetjet për **mirëqenien mendore**. Tre në katër të rinj në Kosovë (77%) shprehën shqetësime të lehta deri në ekstreme në lidhje me përballimin e stresit, dhe 83% mendonin se shëndeti fizik dhe mendor ishin thelbësorë në jetën e tyre. Grupet e fokusit gjithashtu zbuluan se problemet e shëndetit mendor shpesh perceptohen se nuk adresohen dhe pranohen në mënyrë të mjaftueshme në Kosovë.

Aspiratat për të migruar ishin ende një fenomen i përhapur në vitin 2020 në Kosovë, me 53% të të rinjve që deklaruan se **emigrimin** do ta konsiderojnë patjetër ose kanë gjasa të konsiderojnë. Nga ana pozitive, kjo është më e ulët se përqindja prej 58% e anketës së vitit 2018. Sidoqoftë, në vitin 2020 një përqindje më e lartë e të rinjve u deklaruan se migrimin e konsiderojnë patjetër (32%), më shumë se në vitin 2018 (27%). Gjetjet më tej zbuluan se mungesa e mundësive për punë (67%), mungesa e perspektivës personale (45%), si dhe situata e përgjithshme e pafavorshme ekonomike (39%) perceptohen si shkaqe rrënjësore nga më shumë se gjysma e të rinjve që e kanë konsideruar largimin nga Kosova në tri vitet e ardhshme.

Për **arsimin**, ngjashëm me Studimin për Rininë 2018 (48%), rreth gjysma e të gjithë të rinjve që morën pjesë në anketën 2020 ishin duke vijuar shkollimin ose studimet universitare në kohën e intervistës (49%). Të dhënat nga viti 2020 zbuluan gjithashtu se 44% deklaruan se e kishin braktisur shkollimin në institucionet arsimore. Për më tepër, gjetjet tregojnë se arsyeja më e zakonshme e braktisjes ose e mosvazhimit të shkollimit është nevoja për të punuar për të plotësuar të hyrat e familjes (39%), një rritje prej 9 pp krahasuar me gjetjet e vitit 2018. Sidoqoftë, shumica e të rinjve ende në shkollë aspirojnë t'i përfundojnë studimet universitare në të ardhmen (87%), çka tregon një rritje prej 17pp krahasuar me Studimin për Rininë 2018.

Teksa shumica e të anketuarve synojnë të ndjekin studimet universitare, të dhënat zbuluan se të rinjve në Kosovë u është dashur të përballen me një larmi pengesash kur e bëjnë këtë. Një nga pengesat kyçe të identifikuara nga të rinjtë është **mungesa e financave**, siç tregohet nga dy në tre të anketuar (67%). Kjo përfaqëson një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2018 kur vetëm 28% deklaruan se mungesa e financave ua ka penguar qasjen në arsim të mëtejshëm. Gjithashtu doli në pah se vetëm 2% raportuan se kishin marrë fonde publike. Disa pjesëmarrës të grupeve të fokusit kritikuan institucionet e nivelit qendror të Kosovës për mungesën e mbështetjes financiare për studentët, dhe deklaruan se edhe për ata që morën mbështetje, ajo nuk u ishte e mjaftueshme për të siguruar jetesën.

Një tjetër zbulim pozitiv është se shumica e të rinjve mes moshës 14 dhe 17 vjeç nuk raportuan ndonjë problem me **përfshirjen sociale** në shkollat e tyre. Sidoqoftë, duhet të theksohet se pjesëmarrësit e grupeve të fokusit ndanë shembuj të ngacmimit dhe diskriminimit në shkolla ndaj të rinjve që ishin pjesë e komuniteteve rom, ashkali ose egjiptas.

Një gjetje tjetër kyçe është se, në krahasim me vitin 2018, një numër më i lartë i të rinjve në Kosovë ishin të kënaqur me **cilësinë e arsimit** të ofruar në vitin 2020. Më saktësisht, rreth 63% deklaruan se cilësinë e arsimit e konsideronin deri diku të kënaqshme (57% në 2018) dhe 33% shumë të kënaqshme (nga 18% në 2018). Sidoqoftë, pjesëmarrësit serbë të Kosovës të grupeve të fokusit ishin dukshëm më të kënaqur me cilësinë e arsimit të marrë se shumica e pjesëmarrësve shqiptarë të Kosovës që shpesh e vlerësuan cilësinë e arsimit si të dobët. Disa nga arsyet kyçe të dhëna për këtë ishin metodat e vjetruara të mësimdhënies dhe mungesa e burimeve adekuate për mësimnxënie. Pengesat e tjera kryesore të përjetuara gjatë arsimimit nga të anketuarit lidheshin me situatën e dobët ekonomike (35%, një rritje prej 17 për qind krahasuar me 2018, vështirësi me mungesën e literaturës (24%, një rritje prej 2 për qind) dhe cilësinë e dobët të programeve (23%, një rënie prej 5pp).

Në vitin 2020 të rinjtë duket se kanë pak më shumë shpresa kur u pyetën nëse besonin se **arsimi i tyre do të ishte i dobishëm për të gjetur një punë**. Rreth një në tre mendonin se arsimimi i tyre ishte shumë i dobishëm, dy herë më shumë se në vitin 2018 (34% kundrejt 15% në 2018). Sidoqoftë, 22% e të gjithë të anketuarve mendonin se arsimimi i tyre nuk ishte i dobishëm ose nuk ishte aspak i dobishëm kur synonin të siguronin një vend pune.

Rezultatet e të dhënave nga viti 2020 treguan gjithashtu se 58% nuk ishin të angazhuar në asnjë lloj **punësimi**. Krahasuar me gjetjet e vitit 2018, kjo portretizon një rritje prej 41 pp. Nga të rinjtë e papunë, 30% deklaruan se kërkonin punë në mënyrë aktive (rritje prej 20 pp), ndërsa 28% e të papunëve deklaruan se nuk kërkonin ndonjë vend pune (rritje prej 22 pp). Vajzat e reja dhe të anketuarit mes moshës 18 deri në 24 vjeç kishin më shumë gjasa të ishin të papunë dhe të mos kërkonin ndonjë punë (përkatësisht 39% dhe 44%) sesa djemtë e rinj ose ata të grupmoshës nga 25 deri në 35 vjeç (18% dhe 12% përkatësisht).

Një tjetër gjetje shqetësuese e studimit është se 77% e të anketuarve që ishin të papunë nuk kanë as përvojë pune. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit theksuan se për fillestarët në karrierë ishte gati e pamundur të sigurohej një punë duke pasur parasysh që shumica e punëdhënësve presin që të punësuarit e mundshëm ta kenë tashmë një përvojë të caktuar pune. Në përgjithësi, të rinjtë e papunë identifikuan pengesat vijuese kryesore për të gjetur punë: mungesa e vendeve të punës në dispozicion (33%), korrupsioni (32%), nepotizmi në procesin e rekrutimit (31%), dhe mungesa e kualifikimeve profesionale si dhe niveli i kërkuar i përvojës në punë (27% secila). Së fundmi, më shumë se një në tre të rinj të papunë nuk ishin aspak të sigurt se do të gjenin një punë në gjashtë muajt e ardhshëm (35% kundrejt 38% në 2018).

Duke iu kthyer temës së **marrëdhënieve ndëretnike**, gjetjet në këtë studim tregojnë se të rinjtë në Kosovë kanë opinione të ndryshme në lidhje me marrëdhëniet mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Sidoqoftë, një numër i konsiderueshëm i të rinjve ende i shikonin marrëdhëniet si të tensionuara: rreth 21% mendonin se marrëdhëniet ishin të tensionuara, por vitet e fundit kanë ndodhur disa përmirësime (28% në 2018), 16% deklaruan se marrëdhëniet ishin të tensionuara por janë bërë përmirësime të konsiderueshme (16% edhe në 2018), dhe 15% mendonin se marrëdhëniet ishin të tensionuara dhe do të vazhdonin të ishin të tilla. Është pozitive se në vitin 2018 kishte dukshëm më shumë të rinj që mendonin se marrëdhëniet ishin të tensionuara dhe do të vazhdonin të ishin njësoj (27%).

Një në tre përmendi **ndikimin e kujtimeve të konfliktit** si arsyen kryesore që kontribuon në marrëdhëniet e tensionuara (33%), ndërsa gati po aq deklaruan **ndikimin nga gjeneratat e vjetra** si arsye kryesore (29%). Të anketuarit në grupet e fokusit theksuan si faktor kontribues edhe ndikimin e gjeneratës së vjetër dhe paragjykimet e tyre ndaj gjeneratave të reja. Sidoqoftë, disa pjesëmarrës shqiptarë të Kosovës theksuan se të rinjtë po e përmirësonin qasjen e tyre në lidhje me çështje si paragjykimet racore ose etnike në krahasim me gjeneratat e vjetra.

Për t'i **përmirësuar marrëdhëniet**, më shumë se dy në pesë nga të anketuarit (42%) përmendën rritjen e tolerancës dhe mirëkuptimit për njëri-tjetrin, ndërsa 30% përmendën sigurimin e mundësive të barabarta për pjesëmarrje në proceset e vazhdueshme politike, ekonomike dhe sociale. 18% të tjerë mendonin se pjesëmarrja e shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës në aktivitete të përbashkëta mund të ndihmojë në përmirësimin e marrëdhënieve. Disa pjesëmarrës të grupeve të fokusit përmendën se ata kishin pasur paragjykime, por frekuentimi i shkollave të përbashkëta verore dhe programeve të tjera të të rinjve u ka ndihmuar t'i kapërcenin këto anësi. Gjatë Studimit të Rinisë

2018, më shumë të rinj përmendën qasjen edukuese (41%), programet e edukimit ndërmjet grupeve (37%), aktivitetet e përbashkëta (25%) dhe shkollat e integruara (19%) si sugjerime për përmirësim. Vetëm 23% përmendën rritjen e tolerancës dhe mirëkuptimit në vitin 2018.

Në temën e **fesë**, gjetjet treguan se rreth një në tre të rinj (34%) deklaruan se e praktikonin fenë kohë pas kohe. Më shumë të rinj deklaruan se e praktikojnë rregullisht (28%) krahasuar me 2018 (16%) dhe rreth 19% deklaruan se e praktikojnë rrallë (24% në 2018), ndërsa 14% nuk e praktikojnë fare (16% në 2018) Ekstremizmi fetar ishte përjetuar si shumë i përhapur ose deri diku i përhapur nga më shumë se gjysma e të anketuarve në vitin 2020 (53%). Megjithatë, më pak mendonin se ekstremizmi fetar ishte shumë i përhapur (6%) krahasuar me dy vjet më parë (13%).

Është pozitive se të dhënat krahasuese mes studimeve 2018 dhe 2020 tregojnë një rritje në lidhje me **perceptimin e të rinjve për sigurinë**. Rreth 86% raportuan se ndihen shumë të sigurt ose deri diku të sigurt në lagjen e tyre (rritje prej 14 pp) dhe tre në katër të rinj (78%) deklaruan se ndihen shumë ose deri diku të sigurt kur dilnin (11 pp). Gjithashtu, rreth dy të tretat (68%) ndihen shumë të sigurt ose deri diku të sigurt në shkollë (-2pp) dhe 54% ndihen shumë të sigurt ose deri diku të sigurt në vendin e tyre të punës (-1pp). Teksa djemtë dhe vajzat raportuan se ndihen më të sigurt në vitin 2020, më shumë djem ndiheshin shumë të sigurt në zona të ndryshme mes të anketuarve.

Në përgjithësi, **pritjet për të ardhmen** nga të rinjtë në Kosovë mbetën mjaft të ulëta. Ngjashëm me Studimin për Rininë 2018, rreth dy në pesë të anketuar mendonin se ishte deri diku e pamundur që të rinjtë në Kosovë të kishin një jetë më të mirë brenda rreth pesë vjetësh (40%). Rreth 12% perceptonin se kjo nuk ka aspak gjasa të ndodhë. Në vitin 2020, të rinjtë në Kosovë u shfaqën veçanërisht pesimistë në lidhje me përmirësimet në qasjen në punësim dhe situatën politike. Rreth një në tre mendonin se përmirësimi i qasjes në punësim do të kishte deri diku pak gjasa (34%) ose shumë pak gjasa (29%). Përqindja e të anketuarve që mendonin se ky përmirësim do të kishte shumë pak gjasa në 2018 ishte vetëm 5%. Shumica e të gjithë pjesëmarrësve në grupet e fokusit, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjinia ose moshja, u pajtuan se pesë vjet nuk është kohë e mjaftueshme për ndonjë ndryshim thelbësor ose zhvillim pozitiv në Kosovë. Edhe pse shumë pjesëmarrës mbeten pesimist, një numër i konsiderueshëm i të rinjve ndejnë shpresë për të ardhmen e rinisë në Kosovë në vitet që vijnë.

HYRJE DHE SFONDI

Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, çka potencialisht është avantazh i madh, pasi numrat, entuziazmi dhe krijimtaria e tyre mund të jenë një forcë shtytëse për zhvillim. (UNICEF, 2019)

Raporti për Trendet e Tregut të Punës në Ballkanin Perëndimor (2020) nga Banka Botërore dhe Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare theksoi se në vitin 2018 rreth një e pesta e të rinjve në të gjithë rajonin nuk ishin të punësuar, në arsim ose aftësim (NEET). Kur krahason të dhënat mes vendeve të ndryshme të Ballkanit, bëhet e dukshme që Kosova kishte nivelin më të lartë të papunësisë së përgjithshme (25.7%) si dhe papunësinë më të lartë të të rinjve në rajon (46.4%) (Komisioni Evropian (KE), 2020a).

Për më tepër, vazhdimi i pandemisë COVID-19 ka ushtruar trysni shtesë mbi ekonominë e dobët dhe tregun e punës në Kosovë. **Ekonomikisht**, të rinjtë janë prekur në mënyrë disproporcionale nga pandemia, duke marrë parasysh nivelet gjithnjë e më të larta të papunësisë dhe faktin që personat nën moshën 24 vjeç kanë më shumë gjasa të jenë në punë të pasigurt. Numri tashmë alarmues i të rinjve nga 15 deri në 24 vjeç që nuk janë të punësuar, as në arsim ose aftësim (NEET) pritet të rritet për shkak të ndikimit të COVID-19 dhe masave të nevojshme parandaluese të izolimit.

Në raportin e vet mbi ndikimin e krizës COVID-19 në Ballkanin Perëndimor, OECD-ja theksoi se gratë dhe të rinjtë pritej të "vuanin më shumë nga ndërprerjet e biznesit në një numër sektorësh ku ata janë zakonisht të mbipërfaqësuar, siç janë restorantet, hotelet, transporti i udhëtarëve, shërbimet e kujdesit personal dhe shërbimet e kohës së lirë" (OECD, 2020). Për më tepër, sipas Komisionit Evropian, papunësia e të rinjve është rritur nga 46.4% në tremujorin e parë të vitit 2020 në 49.4% në tetor (Komisioni Evropian, 2020a; Komisioni Evropian, 2020b).

Në lidhje me këtë, Raporti i vitit 2019 për Kosovën nga Komisioni Evropian ka kritikuar mungesën e hapave substancialë të ndërmarrë nga institucionet e Kosovës në nivel qendror për zbatimin e strategjisë sektoriale 2018–2022 dhe planit të veprimit kundër papunësisë së të rinjve në vend. Raporti theksoi më tej çështjen e vazhdueshme të mospërputhjes mes rezultateve të arsimit dhe nevojave të tregut të punës (Komisioni Evropian, 2019). Kjo u përsërit edhe në raportin e tij të vitit 2020, ku KE-ja kritikoi shkallën e ulët të zbatimit të strategjisë, pavarësisht nga fakti që synimet e saj u konsideruan modeste që nga fillimi. Përveç kësaj, raporti i vitit 2020 gjithashtu e konsideroi punën e padeklaruar si një nga arsytet kyçe për nivelet e larta të papunësisë në mesin e të rinjve në Kosovë (Komisioni Evropian, 2020b).

Përveç sfidës së papunësisë, të rinjtë e Kosovës po zgjedhin të emigrojnë për shkak të mungesës së arsimit cilësor, mundësive të kufizuara për të marrë pjesë në jetën shoqërore dhe politike, dhe shërbimeve joadekuate të mbështetjes (UNICEF, 2019). Mes këtyre çështjeve, brengat e të rinjve në lidhje me arsimin e tyre janë veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se vetëm 23% e atyre që morën pjesë në Studimin për Rininë nga FES në vitin 2018 deklaruan se ishin të kënaqur me mundësitë për arsim cilësor (Fondacioni Friedrich-Ebert, 2019).

Vazhdimi i pandemisë COVID-19 i ka prekur të rinjtë kosovarë edhe në fusha të tjera të jetës së tyre. Si pjesë e masave të kontrollit, të gjitha shkollat dhe universitetet u mbyllën më 12 mars (OECD, 2020a). Shkollat u rihapën përsëri në 14 shtator, duke përdorur programe të mësimin personal dhe në distancë, kurse institucionet e arsimit të lartë kanë mbajtur kurse online (OECD, 2020b). Si rezultat, sipas gjetjeve të World Vision (2020), disa nxënës jo vetëm që kishin probleme sepse nuk kishin qasje në internet dhe pajisje për mësimin në distancë, por edhe për shkak të mungesës së kontaktit të drejtpërdrejtë

shoqëror me mësimdhënësit dhe shokët e tyre të klasës. Kështu, mbyllja e **sistemit arsimor** dhe kalimi problematik në mësimin në distancë mund të ndikojnë negativisht në mësimnxënien e të rinjve, qasjen në të ushqyerit dhe, rrjedhimisht, në shkallët e diplomimit. Ndërprerja e arsimit ka një efekt veçanërisht negativ tek nxënësit më të varfër, dhe situata është veçanërisht serioze për vajzat dhe gratë e reja që përjashtohen në mënyrë disproporcionale nga arsimi (Informatë për politikën e UN DESA 2020). Gratë dhe vajzat e reja nga komunitetet jo-shumicë dhe ato që jetojnë në varfëri që më përpara kishin shkallë të ulët të frekuentimit shkollor, gjë që rrezikon të përkeqësohet edhe më tej nga pandemia. Pasojat e paparashikuara mund të përfshijnë gjithashtu një rritje të martesave të fëmijëve, një çështje e lidhur kryesisht me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas. Për më tepër, pandemia gjithashtu ka theksuar shkallën e dhunës në familje dhe mungesën e qasjes në grupet e mbështetjes së viktimave dhe shërbimet sociale.

Gjithashtu është raportuar së fundmi se të rinjtë shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës (dhe ata të komuniteteve të tjera jo-shumicë) shpesh ende nuk ndërveprojnë me njëri-tjetrin për shkak të paragjytimeve të rrënjësura thellë dhe mungesës së një gjuhe të përbashkët (UNICEF, 2019) Sidoqoftë, shumica e të rinjve shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës të intervistuar në kuadër të Studimit për Rininë nga Fondacioni Friedrich-Ebert (FES) 2019, nuk e konsideronin të nevojshme të mësonin gjuhët e njëri-tjetrit. Krahas këtyre problemeve, çështjet e varfërisë, mungesa e besimit në institucionet publike, nivelet e larta të emigrimit dhe procesi i gjatë i tranzicionit, kanë lënë pasojë tek rinia e vendit (Friedrich-Ebert-Stiftung, 2019; Komisioni Evropian, 2020b).

Në përgjigje të nevojës për t'i adresuar çështjet e diskutuara më lart, UNDP-UNV, UNICEF dhe UN WOMEN kanë zbatuar bashkërisht projektin "Fuqizimi i Rinisë për një të Ardhshme Paqësore, të Lirë dhe të Qëndrueshme në Kosovë" të financuar nga Fondi për Ndërtim të Paqes i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PBF). Projekti ka synuar të ulë ndikimin e narrativave të konflikteve dhe paragjytimeve, duke angazhuar drejtpërdrejt vajza dhe djem të rinj nga komunitetet e ndara për të punuar së bashku në çështje me interes të përbashkët, për ndërtimin e besimit, përfshirjen sociale dhe kohezionin social. Prandaj, brenda kornizës së tij strategjike, projekti ka monitoruar perceptimin e të rinjve në lidhje me çështjet kyçe sociale, ekonomike dhe politike, dhe, në veçanti pikëpamjet e tyre mbi arsimin, punësimin, fenë, sigurinë dhe marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë. Ky studim u krye në mënyrë që të vëzhgohen dhe kuptohen më mirë këndvështrimet dhe sfidat e të rinjve në Kosovë në vitin 2020. Në të njëjtën kohë, dizajni dhe qasja e hulumtimit e këtij studimi lejojnë krahasimin e gjetjeve të tij me hulumtimin e ngjashëm i ndërmarra në vitin 2018 nga UNDP dhe USAID, me titull "Sfidat dhe këndvështrimet e të rinjve në Kosovë". Përveç përdorimit të rezultateve dhe të dhënave nga ky studim për të reflektuar mbi ndikimin e projektit dhe mësimet e nxjerra, ky studim ofron edhe rekomandime dhe do të ndihmojë në zhvillimin e ndërhyrjeve të targetuara dhe reaguese në të ardhmen.

METODOLOGJIA

Ky hulumtim me metoda të përziera³ bazohet në një anketë përfaqësuese në mbarë Kosovën, me 506 të anketuar mes moshës 14 dhe 35 vjeç, në kombinim me të dhëna cilësore nga shtatë grupe të fokusit të realizuara me gjithsej 43 pjesëmarrës të moshës ndërmjet 17 dhe 35 vjeç. Për studimin, mostra përfshiu 48% femra dhe 52% meshkuj. Sa i përket përkatësisë etnike, shumica e të anketuarve ishin shqiptarë të Kosovës (46%), një e treta ishin serbë të Kosovës (33%), dhe 21% përfaqësuan komunitete të tjera jo-shumicë (ashkali, rom, turk dhe egjiptas). Veç kësaj, si të anketuarit ashtu edhe pjesëmarrësit në grupet e fokusit ishin nga të gjitha rajonet e Kosovës: Prishtina, Gjakova, Ferizaj, Gjlani, Prizreni, Mitrovica dhe Peja.

3.1 KOMPONENTI SASIOR

Për kryerjen e anketës sasiore përfaqësuese kombëtare me N = 506 të anketuar, u aplikua metoda CATI (Intervistimi Telefonik i Asistuar nga Kompjuteri) për shkak të pandemisë COVID-19 në vazhdim, dhe jo intervistimi sy më sy. Një sistem i zhvilluar posaçërisht për këtë metodë gjeneron dhe garanton zgjedhjen rastësore të numrave të telefonave mobil. Pas gjenerimit të një numri, i anketuari i përgjigjej një pyetësori të shkurtër të shqyrtimit për t'u siguruar që ai/ajo i përshtatej kërkesave të mostrimit. Pas kontrollit dhe verifikimit të kuotës, u zhvillua intervista kryesore⁴. Mjetet ekzistuese për mbledhje të të dhënave nga Studimi i mëparshëm për Rininë në vitin 2018 u ndryshuan dhe u përdorën për këtë studim në bashkëpunim të ngushtë me UNDP. Puna në terren u krye në nëntor/dhjetor 2020.

Komunitetet jo-shumicë janë mbipërfaqësuar pak për të mundësuar rezultate domethënëse statistikiisht.

Përndryshe, shpërndarja e mostrës së intervistave ishte bazuar në të dhëna zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (Shih www.askdata.org dhe raportet përkatëse për detaje).

Tabela 1. Shpërndarja e mostrës sipas rajonit

| Rajoni | Përqindja | Intervista N=506 |
|-----------------|-------------|------------------|
| Prishtinë | 29% | 145 |
| Prizren | 20% | 100 |
| Mitrovicë | 12% | 60 |
| Gjilan | 11% | 55 |
| Ferizaj | 10% | 49 |
| Pejë | 10% | 49 |
| Gjakovë | 9% | 48 |
| Gjithsej | 100% | 506 |

³Studimi për Rininë 2020 është përsëritje e studimit të kryer në 2018, prandaj qasja metodologjike i përmbahet në mënyrë rigorozë metodologjisë së zhvilluar më parë në mënyrë që të mundësojë krahasimin e të dhënave.

⁴Në rastin e të anketuarve të mitur, është marrë pëlqimi i prindërve ose kujdestarëve para fillimit të intervistës.

Shpërndarja sipas përkatësisë etnike ishte si më poshtë:

Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas përkatësisë etnike

| Përkatësia etnike | Përqindja | Intervista N=506 |
|-------------------|-------------|------------------|
| Shqiptar | 46% | 233 |
| Serb | 33% | 165 |
| Ashkali | 9% | 47 |
| Rom | 6% | 28 |
| Turk | 4% | 18 |
| Egjiptas | 3% | 13 |
| Boshnjak | 0% | 2 |
| Gjithsej | 100% | 506 |

Shpërndarja moshore e intervistave është siç tregohet më poshtë⁵:

Tabela 3. Shpërndarja e mostrës sipas moshës

| Grupmosha | Përqindja | Intervista N=506 |
|-----------------|-------------|------------------|
| 14-17 | 12% | 59 |
| 18-24 | 45% | 228 |
| 25-35 | 43% | 219 |
| Gjithsej | 100% | 506 |

Shpërndarja gjinore e mostrës ishte 48% vajza të reja, 52% djem të rinj, ndërsa shpërndarja gjeografike ishte 61% rurale dhe 39% urbane. Me një popullatë të vlerësuar prej 704,338 të rinjsh në Kosovë bazuar në Regjistrimin e Popullsisë së viteve 2011 dhe 2019 dhe vlerësimet e ASK-së, marzha e gabimit për një mostër totale prej 506 intervistash në Kosovë është ± 4.35%.

3.2 KOMPONENTI CILËSOR

Në mënyrë që të plotësohet metoda sasiore, u zhvilluan shtatë (7) grupe të fokusit, duke mundësuar kështu njohuri më të thella në çështjet që ishin me interes për këtë raport. Grupet e fokusit u mbajtën në nëntor dhe dhjetor 2020. Kandidatët e përshtatshëm u identifikuan përmes një skanuesi dhe vetëm ata që i plotësuan të gjitha kërkesat e përcaktuara nga kuotat e dëshiruara u ftuan të marrin pjesë. Për shkak të vazhimit të pandemisë COVID-19, grupet u zhvilluan online përmes Skype. U krijua një udhëzues për moderimin në bashkëpunim të ngushtë me UNDP-në për të siguruar që të gjitha temat me interes të kapeshin sa duhet. Parametrat e grupit të fokusit janë në përputhje me kuotën e caktuar nga UNDP paraprakisht dhe mund të gjenden në aneksin e këtij raporti.

⁵Mosha vetëm sipas popullatës së të rinjve 14-25, vlerësimet e të dhënave të ASK 2019

REZULTATET

Kjo pjesë paraqet gjetjet nga anketa sasiore me 506 të rinj në Kosovë dhe u pasurua me gjetje cilësore nga shtatë diskutime në grupet e fokusit. Struktura e këtij kapitulli ndjek seksionet e ndryshme tematike të mjeteve të mbledhjes së të dhënave (pyetësori dhe udhëzuesi i moderimit). Aty ku është e zbatueshme, rezultatet u krahasuan me Studimin për Rininë të kryer në 2018 në mënyrë që të maten ndryshimet me kalimin e kohës.

4.1 PËRBËRJA DEMOGRAFIKE

Sa i përket profilit demografik të pjesëmarrësve, ka pasur një shpërndarje pothuajse të barabartë sipas **gjinisë** (51% meshkuj dhe 49% femra). Në të njëjtën kohë, **grupmoshat** ndryshonin, me rreth 45% të pjesëmarrësve mes 18 deri 24 vjeç, 43% mes 25 deri 35 vjeç, dhe 12% që i përkisnin grupit më të ri (14-17 vjeç).

Figura 1.
Shpërndarja gjinore e të anketuarve





Figura 2.
Shpërndarja moshore e të anketuarve



Sipas **përkatësisë etnike**, gati gjysma e të anketuarve ishin shqiptarë të Kosovës (46%), ndërsa një e treta ishin serbë të Kosovës (33%). Rreth 21% ishin pjesë e komuniteteve të tjera jo-shumicë⁶ në Kosovë (përkatësisht 9% ashkali, 6% romë, 4% turq dhe 3% egjiptas). Gjithashtu, mostra e studimit përfshiu pjesëmarrës të vendosur në të gjithë rajonet e Kosovës, me pothuajse një të tretën e të anketuarve që banonin në Prishtinë (29%), 20% në Prizren, 12% në Mitrovicë, 11% në Gjilan, dhe nga 10% në Ferizaj dhe Pejë, dhe 9% në Gjakovë.

⁶Kur përmenden "komunitetet e tjera jo-shumicë" gjatë gjithë raportit, referenca është për ashkali, romë, turq dhe egjiptas.

Figura 3.
Shpërndarja etnike e të anketuarve





Figura 4.
Shpërndarja rajonale e të anketuarve



Për më tepër, të rinjtë që ishin mbi moshën 18 vjeç u pyetën për **statusin e tyre civil dhe të hyrat personale**. Gati tre në pesë deklaruan se janë beqarë (57%), një në tre ishin të martuar (33%) dhe vetëm 10% jetonin me partnerin/en e tyre ose ishin bashkëjetues.

Në lidhje me **të hyrat personale**, rreth gjysma e të rinjve të anketuar deklaruan se nuk kishin të hyra (51%), ndërsa 19% deklaruan disa fitime. Të hyrat mesatare mes të anketuarve të cilët deklaruan se kishin disa të tilla, ishin 356 euro në muaj, por në të njëjtën kohë duhet të theksohet se gati një e treta nuk pranoi t'i përgjigjej kësaj pyetjeje (30%).

Figura 5.
Statusi civil i të anketuarve mbi 18 vjeç





Figura 6.
Shpërndarja rajonale e të anketuarve




4.2 ÇËSHTJET BRENGOSËSE PËR RININË E KOSOVËS

Kjo pjesë e raportit vlerëson çështjet brengosëse për të rinjtë në Kosovë. Këtu analizohen faktorët që ndikuan në jetën e të rinjve, shqetësimet e tyre dhe nëse ata kanë menduar të emigrojnë në një vend tjetër. Kur është e zbatueshme, të dhënat u krahasuan me rezultatet e Studimit për Rininë 2018 dhe e njëjta gjë vlen për seksionet pasuese të këtij kapitulli.⁷

⁷Rritjet ose uljet në pikë përqindje (pp), gjithnjë i referohen krahasimit me Studimin për Rininë 2018 gjatë gjithë raportit.

Si fillim, të rinjtë (mbi 18 vjeç) u pyetën nëse besonin se Kosova po shkonte në drejtimin e duhur ose të gabuar. Një vëzhgim kyç këtu është se teksa vetëm 9% mendonin se Kosova po ecën në drejtimin e duhur (10% në 2018), një pjesë e lartë e të anketuarve (52%) mendonin se Kosova po ecën në drejtim të gabuar (një rritje e konsiderueshme prej 20pp krahasuar me rezultatet nga vitit 2018). Në tërësi, është e qartë që të rinjtë ndihen gjithnjë e më pesimistë në lidhje me drejtimin nga po ecën Kosova, me rreth një në katër (24%) që konsiderojnë se situata ka stagnuar (nga 48% në 2018).

Figura 7.
Opinioni i të anketuarve nëse Kosova po ecën në drejtimin e duhur




Përqindja e shqiptarëve të Kosovës që mendonin se Kosova po ecën në drejtim të gabuar ishte më e lartë (67%) krahasuar me serbët e Kosovës (27%), ndërsa rreth 28% e serbëve të Kosovës dhe 22% e shqiptarëve të Kosovës e perceptonin situatën si në stagnim. Vetëm 1% e serbëve të Kosovës mendonin se Kosova po ecën në drejtimin e duhur, krahasuar me 11% të shqiptarëve të Kosovës. Duhet të theksohet se 44% e të anketuarve serbë të Kosovës nuk u përgjigjën në këtë pyetje, ndërsa asnjë nga të anketuarit shqiptarë të Kosovës nuk refuzoi të përgjigjet në lidhje me këtë çështje. Komunitetet e tjera jo-shumicë e treguan veten kryesisht pesimistë (62%), ndërsa rreth 21% mendonin se situata kishte stagnuar. Është pozitive se 17% e të anketuarve nga komunitetet e tjera jo-shumicë mendonin se Kosova po ecën në drejtimin e duhur.

Gjetjet e grupeve të fokusit (GF) nënvizuan rezultatet e mësipërme, pasi pothuajse të gjithë pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës mendonin se Kosova po ecën në drejtimin e gabuar. Këtë, disa ia atribuuan situatës së përgjithshme politike në Kosovë, politikanët shpesh perceptoheshin si egoistë me pak kujdes për të rinjtë e vendit. Të tjerët përmendën situatën socio-ekonomike, mungesën e përgjithshme të mundësive dhe papunësinë si arsye kryesore për një perspektivë pesimiste. Pjesëmarrësit më të rinj (17-19 vjeç) shqiptarë të Kosovës në GF u shprehën deri diku me më shumë shpresë se të tjerët. Ata besonin se të rinjtë e Kosovës, përmes aktivizmit dhe protestës, mund të ishin në gjendje të sillnin ndryshime pozitive në vend.


Figura 8.

Opinionii i të anketuarve nëse Kosova po ecën në drejtimin e duhur, sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike



Mungesa e mundësive për punë (81%), varfëria/situata e dobët ekonomike (68%) dhe nepotizmi/korrupsioni (42%) ishin **tre sfidat më të mëdha** të përmendura nga të rinjtë në Kosovë (mbi 18 vjeç). Një pjesë tjetër prej 20% përmendën situatën e përgjithshme politike dhe 17% cilësinë e ulët të arsimit. Në krahasim me vitin 2018, më shumë të rinj përmendën mungesën e mundësive për punë (81% në 2020 kundrejt 60% në 2018, një rritje prej 21 pp), varfërinë (68% në 2020 kundrejt 49% në 2018, një rritje prej 19 pp) dhe pothuajse e njëjta përqindje e të anketuarve përmendën nepotizmin/korrupsionin (42% në 2020 kundrejt 43% në 2018, një rënie prej 1pp). Nga ana tjetër, cilësia e ulët e arsimit u përmend nga 29% në 2018 dhe vetëm nga 17% në 2020 (rënie prej -12pp).

Figura 9.
Tri sfidat kryesore të të rinjve në Kosovë




Gjetjet cilësore treguan qartë se pavarësisht nga përkatësia etnike, mosha ose gjinia, pjesëmarrësit në GF u pajtuan se **papunësia ishte sfida kryesore për të rinjtë në Kosovë**. Mospërputhja mes nevojave të tregut të punës dhe profileve të të diplomuarve të rinj në Kosovë u përmend si një faktor i rëndësishëm. Nepotizmi u përmend në të gjithë grupet e fokusit si një problem i dukshëm, dhe kishte shumë që mendonin se sigurimi i një pune ishte i mundur vetëm kur dikush kishte lidhje të forta. Disa nga pjesëmarrësit mes moshës 17 dhe 19 vjeç ndjeheshin të diskriminuar për shkak të moshës së tyre të re. Grupet e fokusit me shqiptarët e Kosovës zbuluan se cilësia e dobët e arsimit, më së shpeshti për shkak të metodave të vjetëruara të mësimdhënies dhe stafit arsimor të paaftë/të vjetër, shpesh përjetohej si një sfidë e madhe. Kjo bënte dallim nga pjesëmarrësit serbë të Kosovës të cilët ishin kryesisht të kënaqur me cilësinë e arsimit të tyre.

Vajzat e reja që morën pjesë në anketë e përmendën më shpesh **mungesën e mundësive për punë** si sfidë (85%) sesa djemtë e rinj (78%). Në të kundërt, meshkujt e përmendën situatën e përgjithshme politike më shpesh si sfidë të madhe sesa femrat (përkatësisht 24% kundrejt 15%). Dallimet në grupmoshat ishin gjithashtu të dukshme. Më shumë të anketuar të grupmoshës më të vjetër (25–35 vjeç) përmendën mungesën e mundësive për punë (84%) sesa ata që i përkasin grupmoshës 18 deri 24 vjeç (79%). Të anketuarit më të rritur ishin gjithashtu më të prirur të përmendnin nepotizmin/korrupsionin (48%) sesa të rinjtë (36%).

Më pak të anketuar serbë të Kosovës mendonin se mungesa e mundësive për punë ishin sfidë e madhe (67%) krahasuar me shqiptarët e Kosovës (89%). E njëjta qëndron edhe për sfidat që lidhen me varfërinë dhe nepotizmin/korrupsionin. Sidoqoftë, dukshëm më shumë serbë të Kosovës mendonin se situata e përgjithshme politike përbënte sfidë të madhe për të rinjtë në Kosovë (40%) krahasuar me shqiptarët e Kosovës (12%). Pjesëmarrësit serbë të Kosovës të grupeve të fokusit gjithashtu theksuan si shqetësim mosnjohjen e diplomave kosovare nga vendet e tjera.


Figura 10.
Tri sfidat kryesore të të rinjve në Kosovë,
sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike




Më pas, të rinjtë mbi moshën 18 vjeç u pyetën nëse kanë votuar në zgjedhjet lokale dhe kombëtare në Kosovë. Gati dy në tre deklaruan se zakonisht votojnë (62%), ndërsa rreth 13% kanë votuar ndonjëherë dhe vetëm 7% kanë deklaruar se zakonisht nuk marrin pjesë në proceset e votimit.

Djemtë e rinj (67%) dhe ata që i përkasin grupmoshës 25–35 vjeç (76%) kanë më shumë gjasa të kenë votuar sesa vajzat e reja (57%) ose ato që i përkasin grupmoshës më të re (48%). Të anketuarit serbë të Kosovës treguan një përqindje më të lartë të atyre që kanë votuar ndonjëherë (25%), krahasuar me shqiptarët e Kosovës (6%). Në përgjithësi, më shumë shqiptarë të Kosovës dhe të anketuar nga komunitetet e tjera jo-shumicë zakonisht kanë dalë për të votuar (përkatesisht 75% dhe 78%) sesa serbët e Kosovës (36%). Duhet të theksohet se 20% e të anketuarve serbë të Kosovës nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.

Figura 11.
Sjellja e votimit në zgjedhjet lokale dhe kombëtare në Kosovë



Në vitin 2018, një pjesë më e lartë e të rinjve deklaruan se zakonisht nuk votojnë (16%) sesa në vitin 2020 (7%). Gjithashtu, në 2020 pak më shumë pohuan se kanë votuar zakonisht sesa në 2018 (62% kundrejt 56%).




Në vijim, të anketuarve u kërkua të vlerësonin rëndësinë e temave të caktuara në jetën e tyre, si shëndetësia, familja, shkolla dhe siguria financiare. Rreth tetë në 10 të rinj mendonin se **shëndeti fizik dhe mendor** ishin jashtëzakonisht të rëndësishëm në jetën e tyre (83% kundrejt 49% në 2018) dhe gati po aq shumë deklaruan se **marrëdhëniet familjare** janë jashtëzakonisht të rëndësishme (81% kundrejt 43% në 2018). Rreth 59% gjithashtu mendonin se **shkolla ose studimet dhe siguria financiare** ishin aspekte jashtëzakonisht të rëndësishme në jetën e tyre (kundrejt përkatësisht 28% dhe 31% në 2018). **Miqësitë** u deklaruan si jashtëzakonisht të rëndësishme ose të rëndësishme nga 49% ndërsa vetëm 26% deklaruan të njëjtën gjë në 2018.

Në përgjithësi, krahasuar me vitin 2018, të gjitha aspektet perceptohen më shpesh si shumë të rëndësishme në jetën e të rinjve në vitin 2020. Disa pjesëmarrës shqiptarë të Kosovës në GF gjithashtu theksuan rëndësinë e adresimit dhe njohjes së çështjeve të shëndetit mendor te të rinjtë në Kosovë.

... një problem shumë i rëndësishëm është shëndeti mendor dhe njerëzit nuk flasin për këtë. Njerëzit nuk duan të shkojnë tek psikologu. Prindërit tanë mund të mos na kuptojnë aktualisht, pasi ata kishin stil jetese krejtësisht të ndryshme kur ishin të vegjël dhe ata nuk e kuptojnë depresionin. (Një i ri shqiptar i Kosovës (21) nga Gjilani)

Figura 12.
Aspekte të rëndësishme në jetën e të rinjve




Gjatë vlerësimit të **shqetësimeve personale të të rinjve** në Kosovë në lidhje me çështje të ndryshme, të dhënat zbuluan se 77% shprehën shqetësime të lehta deri në ekstreme në lidhje me përballimin e stresit, më shumë se gjysma e tyre shprehën shqetësime të vogla deri në ekstreme në lidhje me problemet e punës (54%) dhe 50% ndaj problemeve shkollore.

Pjesëmarrësit në grupet e fokusit shprehën gjithashtu se ata nuk ndiheshin të përfaqësuar mirë nga institucionet e tyre të nivelit qendror. Strategjitë për të mbështetur dhe përfshirë të rinjtë shpesh ishin formuluar mirë në letër, por zbatimi ishte përjetuar si i dobët.

Për më tepër, duhet të theksohet se kur shikojmë nga afër vetëm ata që shprehën shqetësime të moderuara dhe ekstreme, pesë çështjet e mëposhtme u dalluan më shumë: droga (38%), alkooli (29%), diskriminimi (28%), bixhozi (26%) dhe problemet e punës (25%).


Figura 13.
Shqetësimet personale të të rinjve në Kosovë



Të rinjtë shpesh pozicionohen brenda grupeve të tyre të kolegëve dhe vëzhgojnë, si dhe përvetësojnë, sjellje të ekspozuara nga të tjerët. Prandaj, ishte e rëndësishme të eksplorohej nëse të anketuarit kanë dëshmuar shoqërinë e tyre duke u marrë me ndonjë lloj sjellje ose përvojë të rrezikshme gjatë 12 muajve të fundit. Gati tre në katër të rinj kanë dëshmuar disa nga shokët e tyre duke pirë duhan (71%) gjatë 12 muajve të fundit. Rreth dy në pesë deklaruan se disa nga shokët e tyre kanë braktisur shkollën (39%) dhe 22% kanë dëshmuar një shok që është pezulluar nga shkolla. Pirja e alkoolit (20%), mbajtja e një thike (15%), bixhozi dhe problemet e lidhura me gjininë (12% secili), ishin gjithashtu çështje që u dëshmuar nga një numër i konsiderueshëm i të anketuarve në grupet e tyre shoqërore.

Figura 14.


Të anketuarit që kishin shokë të përfshirë në sjellje ose përvoja të rrezikshme gjatë 12 muajve të fundit



Aspiratat për të emigruar ishin ende një fenomen i përhapur në vitin 2020 në Kosovë, me 53% të të rinjve që deklaruan se migrimin do ta konsiderojnë ose kanë gjasa të konsiderojnë. Në vitin 2018, kjo përqindje arriti në 58%.

Konkretisht, në vitin 2020, rreth një në tre të rinj do ta "konsideronin patjetër" migrimin brenda tri viteve të ardhshme (32%), dhe një pjesë tjetër prej 21% deklaroi se "kanë gjasa ta konsiderojnë". Krahasuar me vitin 2018, një përqindje më e lartë e të rinjve deklaruan se e konsiderojnë patjetër migrimin (27%).


Figura 15.
Përgjigjet e të anketuarve nëse do ta konsiderojnë migrimin brenda tre viteve të ardhshme



Më shumë djem të rinj (35%) do ta konsideronin patjetër migrimin sesa vajzat e reja (28%). Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se të rinjtë shqiptarë të Kosovës më shpesh vendosnin për migrim (30% patjetër, 22% me gjasë) kur krahasohen me të rinjtë serbë të Kosovës (22% patjetër, 23% me gjasë). Gjysma e atyre që u përkasin komuniteteve të tjera jo-shumicë deklaruan se patjetër kishin menduar të migronin brenda tre viteve të ardhshme (50%).

Shumë pjesëmarrës shqiptarë të Kosovës në grupet e fokusit gjithashtu kanë konsideruar migrimin; megjithatë, shpesh me synimin për t'u kthyer pas një kohe (migrimi qarkor). Disa shprehën preferencën për të qëndruar në Kosovë në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin lokal dhe të qëndrojnë të lidhur me familjet e tyre. Pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës u pajtuan se migrimi ishte një fenomen i përhapur në Kosovë, megjithëse pjesëmarrësit serbë të Kosovës ishin më të prirur ta konsideronin migrimin në të ardhmen nëse situata aktuale në vend nuk përmirësohej.

Figura 16
Përgjigjet e të anketuarve nëse do ta konsiderojnë migrimin brenda tre viteve të ardhshme



Arsyeja numër një për të konsideruar emigrimin ishte ende mungesa e mundësive për punë në Kosovë sipas 67% të të anketuarve (55% në 2018). Një pjesë tjetër prej 45% deklaroi mungesën e perspektivës personale si arsye (32% në 2018) dhe 39% përmendën situatën e pafavorshme ekonomike në familje/nivelin e ulët të të hyrave (38% në 2018). Gjetjet e grupeve të fokusit nënvizuan më tej çështjet e lartpërmendura, shumë përmendin mungesën e punësimit, vështirësitë financiare dhe mungesën e perspektivës. Veç kësaj, një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve do ta konsideronin migrimin për qëllime arsimore.

Figura 17.
Tri arsyet kryesore për emigrim





Figura 18.
Tri sfidat kryesore të të rinjve në Kosovë,
sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike




4.3 QASJA NË ARSIM

Kjo pjesë tematike ka të bëjë me çështjet e arsimit. Ndër të tjera, ajo analizon qasjen në arsim, kënaqshmërinë me cilësinë e arsimit, si dhe pengesat ndaj angazhimit në arsimin e lartë.

Ngjashëm me Studimin për Rininë 2018 (48%)⁸, rreth gjysma e të gjithë të rinjve që morën pjesë në këtë anketë ishin duke **vijuar shkollimin ose studimet universitare** në kohën e intervistës⁹ (49%). Të dhënat nga viti 2020 zbuluan gjithashtu se 44% e kanë braktisur shkollën, ndërsa 7% të tjerë deklaruan se nuk e kanë frekuentuar kurrë shkollën ose universitetin. Shumica dërrmuese e atyre që nuk e kanë frekuentuar kurrë shkollën ose universitetin, nuk kanë planifikuar të merren me arsimim brenda dy viteve të ardhshme (94%).

Figura 19.
Frekuentimi i shkollës ose universitetit
në kohën e intervistës




⁸Kjo pyetje u redaktua në vitin 2020. Në vitin 2018 opsionet e përgjigjes ishin "po" ose "jo" nëse të anketuarit kanë frekuentuar shkollën/universitetin. Në vitin 2020, opsionet e përgjigjes ishin "po", "jo, kurrë nuk e kam frekuentuar" dhe "jo, e braktisa".

⁹Intervistat e anketës dhe grupet e fokusit u zhvilluan në nëntor/dhjetor 2020

Raporti i djemve të rinj që e kanë **braktisur shkollën ose universitetin** ishte më i lartë (48%) krahasuar me vajzat e reja (40%). Shkalla e braktisjes së shkollës ishte veçanërisht e lartë në mesin e të anketuarve më të vjetër mes moshës 25 dhe 35 vjeç (67%), atyre që u përkasin komuniteteve të tjera jo-shumicë (66%) dhe shqiptarëve të Kosovës (48%). Vetëm një e treta e të anketuarve 18-24 vjeç (33%) dhe 25% e serbëve të Kosovës raportuan ta kenë braktisur shkollën.


Figura 20
Përgjigjet e të anketuarve nëse do ta konsiderojnë migrimin brenda tre viteve të ardhshme



Shumica e të rinjve mes moshës 14 dhe 17 vjeç e frekuentonin shkollën në kohën e intervistës (92%), dhe të gjithë ata e frekuentonin shkollën rregullisht (100%). Të rinjve të kësaj grupmoshe iu prezantuan tri deklarata në lidhje me përvojat dhe ndjenjat e tyre të përfshirjes sociale në shkollë dhe u pyetën nëse pajtoheshin apo jo.

Rreth 89% ose u pajtuan ose u pajtuan plotësisht se është më e lehtë të bësh shokë në shkollë, ndërsa 87% u pajtuan plotësisht ose u pajtuan se ndihen që përkasin në shkollat e tyre. Pothuajse të gjithë (97%) nuk u pajtuan ose nuk u pajtuan plotësisht me thënien "Në shkollën Ora, ndihem i vetmuar".

Figura 21.
Pajtimi me deklarata në lidhje me përvojat e përfshirjes sociale në shkollë



Sidoqftë, disa gjetje të grupeve të fokusit hedhin dritë mbi çështjet e **ngacmimit dhe diskriminimit** në shkollat në Kosovë, veçanërisht në lidhje me të rinjtë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas.

Ju nuk e keni idenë me sa gjykim, diskriminim dhe ngacmim përballen ata, dhe këta janë faktorët kyç pse [romët, ashkallitë dhe egjiptasit] e lënë shkollën [...] shumica e familjeve në Kosovë i përdorin komunitetet tona si 'shembuj të këqij': për shembull, nëse një fëmijë nuk sillet mirë, ata i thonë atij ose asaj "mos u bo si maxhup") dhe kjo i bën fëmijët të rriten me paragjykime dhe të mendojnë se të rinjtë e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptas nuk kanë mirësjellje, nuk janë të pastër, etj. (Një i ri ashkali (27) nga Shtime)

Gjetjet e të dhënave gjithashtu treguan se të rinjtë kalojnë kohë të konsiderueshme në internet (20.8 orë në javë mesatarisht), ndërsa kalojnë pak orë lexim (8.7 orë mesatarisht). Të anketuarit më të rinj dhe meshkujt kalonin më së pakti kohë me lexim (përkatësisht 7.9 dhe 7.7) kur krahasohen me vajzat ose të anketuarat më të vjetra.

Tabela 11


Orët për javë të kaluara në aktivitete të ndryshme

| | Orët për javë të kaluara në: | | | | | |
|---|------------------------------|---------|-------|------------|--------------|--------------|
| | Gjithsej | Gjinia | | Moshë | | |
| | | Meshkuj | Femra | 14-17 vjeç | 18 - 24 vjeç | 25 - 35 vjeç |
| Shkolla dhe detyrat e shtëpisë (vetëm 14 - 17 vjeç) | 25.0 | 22.0 | 26.7 | 25.0 | - | - |
| Internet (përfshirë rrjete sociale) | 20.8 | 23.1 | 18.4 | 20.7 | 24.2 | 17.3 |
| Lexim | 8.7 | 7.7 | 9.8 | 7.9 | 9.6 | 8.1 |

Pjesa më e madhe e të rinjve mes moshës 14 dhe 17 vjeç **aspirojnë ta marrin një diplomë universitare** (87%). Kjo portretizon një rritje krahasuar me Studimin për Rininë të kryer në vitin 2018, atëherë 70% kishin për qëllim marrjen e një diplome universitare. Rreth dy në pesë dëshirojnë të përfundojnë një program Bachelor (39%), ndërsa 26% deklaruan se synojnë një doktoraturë/PhD. Një pjesë tjetër prej 22% raportuan se aspironin përfundimin e një programi Master.


Figura 22.

Shqetësimet personale të të rinjve në Kosovë



Një varg **pengesash** kanë ndikuar që të rinjtë në Kosovë të mos ishin në gjendje të merrnin pjesë në arsimin e lartë përtej shkollës së mesme. Të dhënat sugjerojnë se **mungesa e financave perceptohej si një pengesë e rëndësishme për të frekuentuar universitetin** për dy në tre të rinj (67%)¹⁰. Kjo portretizon një rritje të konsiderueshme krahasuar me 2018, kur vetëm 28% deklaruan se mungesa e financave paraqiste një pengesë të konsiderueshme. Dy në tre gjithashtu raportuan notat e dobëta shkollore si një pengesë e rëndësishme ose e madhe ndaj vazhdimin të arsimit të tyre (66% të kombinuar, në vitin 2018 kjo përqindje ishte vetëm në 24%). Një numër i rritur i të rinjve gjithashtu e shihte mungesën e mbështetjes familjare si një pengesë kryesore ndaj aspiratës për t'u angazhuar në arsimin e lartë në vitin 2020 (33%), kur krahasohet me rezultatet e Studimit për Rininë në vitin 2018 (8%). Nevoja për të hyrë në punë për të mbështetur familjen/plotësimin e të hyrave të familjes u përmend si një pengesë e vogël nga 33% e të rinjve.¹¹

Figura 23.
Pengesat ndaj vazhdimin të arsimit
përtej shkollës së mesme



Në përgjithësi, kur u pyetën për **arsimin më të lartë të përfunduar**, 42% deklaruan se kishin mbaruar shkollën e mesme, 21% kanë diplomë Bachelor, dhe 13% kanë përfunduar shkollën fillore. Rreth 39% e atyre të anketuarve që e kanë braktisur shkollën ose nuk e kanë vazhduar shkollimin përtej shkollës së mesme, u arsyetuan se duhej të plotësonin të hyrat e familjes. Në vitin 2018, kjo arsye u përmend nga 30% e të anketuarve.

Arsye të tjera për braktisjen e shkollës në vitin 2020 ishin detyrimi për t'u kujdesur për anëtarët më të rinj të familjes (9% e të anketuarve) dhe krijimi i një familjeje (gjithashtu 9%). Për dallim, në vitin 2018, krijimi i një familje përmendet dukshëm më shumë (27%) si arsye për të mos u angazhuar në arsim ose për braktisjen e shkollës.

Për më tepër, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në grupet e fokusit njihnin dikë që e kishte braktisur shkollën për shkak të çështjeve financiare dhe shumë raportuan se ata nuk i janë kthyer arsimit të tyre në një moment të mëvonshëm në kohë.

¹⁰Kjo pyetje iu drejtua të anketuarve nga moshën 14 deri në 17 vjeç.

¹¹Ky opsion i përgjigjes iu shtua pyetësorit të anketës në vitin 2020.

Figura 24.
Shkollimi
më i lartë i përfunduar






Figura 25.
Arsyet e braktisjes së shkollës
ose universitetit



Të anketuarit që kanë diplomë të Asociuar, diplomë Bachelor ose Master/Doktoraturë u pyetën më pas nëse ata ishin të kënaqur me **cilësinë e arsimit** të marrë. Gjetjet krahasuese treguan se kënaqshmëria me cilësinë e arsimit është rritur në përgjithësi.


Rreth 63% deklaruan se cilësinë e arsimit e konsideronin deri diku të kënaqshme dhe 33% shumë të kënaqshme, në krahasim me vitin 2018 ku vetëm 57% dhe 18% përkatësisht deklaruan të njëjten gjë. Vetëm 2% ishin deri diku të pakënaqur ose aspak të kënaqur në vitin 2020.

Figura 26.
Kënaqshmëria me arsimin e lartë të marrë



Kur hidhet një vështrim më nga afër mbi gjetjet e zberthyer sipas përkatësisë etnike, mund të vërehet se të gjithë shqiptarët e Kosovës dhe të gjithë serbët e Kosovës ishin të kënaqur ose deri diku të kënaqur me cilësinë e arsimit të tyre. Vetëm disa nga të anketuarit që vijnë nga komunitete të tjera jo-shumicë deklaruan se ishin deri diku të pakënaqur ose aspak të kënaqur (17%). Sidoqoftë, diskutimet në grupet e fokusit zbuluan një pamje të ndryshme nga gjetjet e të dhënave sasiore; Sidoqoftë, pjesëmarrësit serbë të Kosovës të grupeve të fokusit ishin dukshëm më të kënaqur me cilësinë e arsimit të marrë se shumica e pjesëmarrësve shqiptarë të Kosovës që shpesh e vlerësuan cilësinë e arsimit si të dobët. Arsytet më të zakonshme të përmendura nga pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës ishin metodat e vjetruara të mësimdhënies, përqendrimi në "mësimnxënien përmendësh të lëndëve" dhe jo mbi të kuptuarit e logjikës përkatëse, dhe personeli i vjetër/joprofesional arsimor. Probleme krijojnë edhe burimet e përshtatshme për mësimnxënie dhe mungesa e literaturës.

Figura 27.
Kënaqshmëria me arsimin e lartë të marrë,
sipas përkatësisë etnike



Në vitin 2020 të anketuarit duket se kanë më shumë shpresa kur u pyetën nëse besonin se **arsimi i tyre do të ishte i dobishëm për të gjetur një punë**.

Rreth një në tre mendonin për arsimin e tyre si shumë të dobishëm, rreth dy herë më shumë se në 2018 (34% kundrejt 15% në 2018), ndërsa 40% e vlerësuan atë si deri diku të dobishëm (49% në 2018). Sidoqoftë, 22% të kombinuar mendonin se arsimimi i tyre nuk ishte i dobishëm ose nuk ishte aspak i dobishëm kur synonin të siguronin një vend pune. Veçanërisht të anketuarit në moshë më të madhe (25 deri 35 vjeç) ishin më pak optimistë; 17% mendonin se arsimi i tyre nuk ishte i dobishëm dhe 12% mendonin se arsimi i tyre nuk ishte aspak i dobishëm kur përpiqeshin të siguronin punësim.

Gjetjet e grupeve të fokusit zbuluan se teksa disa u ankuan për mospërputhjen e profileve të të diplomuarve dhe nevojave të tregut të punës, të tjerët mendonin se arsimimi i tyre ka qenë i dobishëm për gjetjen e një pune. Sidoqoftë, pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës të grupeve të fokusit kishin përjetuar se pa lidhje dhe kontakte të mjaftueshme, sigurimi i një pune mund të jetë i rëndë (nepotizëm).

Figura 28.
Dobia e arsimit për gjetjen e një pune





Figura 29.
Dobia e arsimit për gjetjen e një pune, sipas moshës




Të rinjtë në Kosovë janë përballur me **pengesa të ndryshme gjatë angazhimit në arsim**. Më shumë se një në tre kanë përjetuar një situatë të dobët ekonomike (35%, një rritje prej 17 pp krahasuar me 2018), rreth një në katër kishte vështirësi me mungesën e literaturës (24%) ose cilësinë e dobët të programit (23%). Vlerësimi i padrejtë nga mësuesit ose profesorët dhe infrastruktura e dobët shkollore u përmendën gjithashtu si pengesa kryesore nga 21% e të anketuarve. Pjesë të tjera prej 17% dhe 16% përkatësisht përmendën nivelin e ulët të profesionalizmit të personelit arsimor dhe nepotizmin/korrupsionin në vitin 2020. Pjesëmarrësit në grupet e fokusit gjithashtu theksuan se mungesa e mjeteve financiare përbënte një sfidë për shumë njerëz, shumica njihnin dikë që i është dashur t'i linte studimet për shkak të çështjeve financiare.

Kur krahasuan më tej këto rezultate me pulsën e të rinjve 2018, u vu re se më shumë të rinj mendonin se pengesa ishin niveli i ulët i profesionalizmit nga stafi arsimor (38%), klasat e mbipopulluara (20%) dhe mungesa e sigurisë dhe sigurimit rreth shkollës (17%), krahasuar me vitin 2020. Teksa pjesëmarrësit serbë të grupeve të fokusit ishin më të kënaqur me cilësinë e përgjithshme të arsimit të marrë, disa theksuan edhe probleme. Ndër të tjera, femrat pjesëmarrëse serbe të Kosovës theksuan problemin e korrupsionit në sistemin arsimor në Kosovë.

Një student më tregoi një mesazh ku ai e zgjidh një provim me një profesor dhe negocion çmimin në metra kub dru. Kjo do të thotë, sa metra kub dru duhet t'i japë studenti profesorit, kështu që profesori ta kalojë në provim. (Vajzë e re serbe e Kosovës (26) nga Graçanica)

Figura 30.
Pengesat kryesore të dëshmuara gjatë arsimimit




Gjetjet e studimit të zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë më tej se serbët e Kosovës kishin më shumë gjasa të përmendnin nepotizmin/korrupsionin (35%) si pengesën kryesore të dëshmuar gjatë arsimimit të tyre sesa të anketuarit shqiptarë të Kosovës (9%) ose ata që vijnë nga komunitete të tjera jo-shumicë (4%). Serbët e Kosovës gjithashtu më shpesh përballen me vështirësi për shkak të një situatë të dobët ekonomike (47%) krahasuar me të anketuarit që vijnë nga komunitete të tjera jo-shumicë (38%) ose shqiptarë të Kosovës (24%). Nga ana tjetër, shqiptarët e Kosovës përmendën cilësinë e dobët të programeve (31%) dhe infrastrukturën e dobët shkollore (27%) më shpesh sesa serbët e Kosovës (përkatësisht 21% dhe 11%).

Duke parë nga afër ndryshimet në **grupmosha** të ndryshme, gjetjet tregojnë se më shumë nga të anketuarit më të rritur (25 deri në 35 vjeç) e përmendën situatën e dobët ekonomike (42%) si pengesë krahasuar me grupmoshat më të reja (18 deri në 24 vjeç, 32% dhe 14 deri në 17 vjeç, 20%). Të anketuarit mes moshës 14 dhe 17 vjeç përmendën më shpesh infrastrukturën e dobët shkollore (32%) dhe vlerësimin e padrejtë nga stafi arsimor (29%) si pengesat kryesore të dëshmuara gjatë arsimimit të tyre. Mungesa e literaturës dhe nepotizmi/korrupsioni janë dëshmuar më së shpeshti nga të anketuarit mes moshës 18 dhe 24 vjeç (përkatësisht 28% dhe 21%).

Figura 31.


Pengesat kryesore të dëshmuara gjatë arsimimit, sipas moshës dhe përkatësisë etnike



Tre në pesë të rinj mendonin se aftësimi profesional do të ishte shumë i dobishëm për të ardhmen e tyre (60%), 25% të tjerë besonin se do të ishte deri diku i dobishëm. Sidomos ata që i përkasin grupmoshës më të re mendonin se aftësimi profesional mund të ishte shumë i dobishëm për të ardhmen e tyre (78%). Për më tepër, pak më shumë femra (63%) e perceptonin aftësimin profesional si shumë të dobishëm sesa meshkuj (58%). Nga ana e kundërt, më shumë meshkuj (8%) sesa femra (4%) mendonin se aftësimi profesional ka pak vlerë për ta.

Figura 32.

Dobia e perceptuar e aftësimin profesional për të ardhmen e të rinjve



Në përgjithësi, përkundër disa gjetjeve pozitive në këtë studim sa i përket perceptimit të të rinjve në lidhje me cilësinë e arsimit të tyre, **nevojitet më shumë hulumtim për të reflektuar mbi të tashmen dhe të ardhmen e arsimit në Kosovë.** Për shembull, cilësia e ulët e arsimit rezultoi në performancë të dobët të studentëve në Programin OECD 2018 për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA), duke i vendosur nxënësit e Kosovës në fund të botës në zhvillim dhe të fundit në Ballkanin Perëndimor. Në të njëjtën kohë, siç theksohet nga studime të ndryshme përfshirë Raportin e Komisionit të BE-së për Kosovën 2020, sistemi arsimor nuk arrin t'u sigurojë të rinjve shkathtësi për të përmbushur kërkesat e tregut lokal dhe global duke penguar pavarësinë e tyre, duke i përjashtuar më tej ata që janë të cenueshëm, dhe duke kontribuar deri në përjashtimin politik dhe ekonomik.

4.4 TRANZICIONI NË PUNËSIM

Të anketuarve mes moshës 18 dhe 35 vjeç iu prezantuan edhe një numër pyetjesh në lidhje me temën e **tranzicionit në punësim.** Kjo përfshinte, ndër të tjera, pyetje në lidhje me statusin e tyre të punësimit, të hyrat, llojet e punëve në të cilat angazhoheshin, dhe vështirësitë me të cilat përballeshin kur kërkonin punë.


Kur pyeten për aktivitetin e tyre aktual të punës,¹² të dhënat zbuluan se **58% e të anketuarve nuk ishin të angazhuar në asnjë lloj punësimi.** Krahasuar me gjetjet e vitit 2018, kjo portretizon një rritje prej 41 pp. Nga të rinjtë e papunë, 30% deklaruan se kërkonin punë në mënyrë aktive (rritje prej 20 pp), ndërsa 28% e të papunëve deklaruan se po kërkojnë vend pune (rritje prej 22pp).

Gjetjet e të dhënave nga studimi i vitit 2020 përputhen me realitetin e përgjithshëm në Kosovë kur shqyrtohen të dhënat zyrtare statistikore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK); të dhënat e ASK-së nga viti 2019 treguan se 49% e të anketuarve 15–24 vjeç dhe 31% e 25–34 vjeç ishin të papunë (ASK, 2019a). Pjesa e të rinjve NEET në popullatën e të rinjve ishte 32% në 2019, më shumë vajza të reja (34%) sesa djem të rinj (31%) ishin NEET në 2019 sipas ASK (ASK, 2019b). Për më tepër, kur vlerësohen gjetjet e të dhënave të vitit 2020, duhet të kihet parasysh ndikimi i vazhdimit të pandemisë COVID-19 në ekonomi dhe tek njerëzit në Kosovë.

Ashtu si në gjetjet e vitit 2018 (36%), rreth një e treta deklaruan se punojnë me orar të plotë (34%). Sidoqoftë, puna me orar të pjesshëm ka rënë ndjeshëm nga 22% në vetëm 5%, dhe vetëm 2% deklaruan vetëpunësim krahasuar me 22% të të anketuarve në 2018.

Figura 33.

Aktivitetet aktuale të punësimit të të rinjve



¹²Në kohën e intervistës, nëntor/dhjetor 2020.


Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë treguan se vajzat e reja kishin më shumë gjasa të ishin të papuna dhe të mos kërkonin ndonjë punë (39%) krahasuar me djemtë e rinj (18%). Vetëm 27% e femrave të reja ishin të angazhuara me çdo lloj pune, krahasuar me 54% të meshkujve të rinj. Kur krahasohen të dhënat e vitit 2018 dhe 2020, përqindja e femrave të reja që ishin të papuna dhe që nuk kërkonin punë është rritur me 36 pp.

Më tej doli në pah se të anketuarit më të rinj (18 deri 24 vjeç) kishin më shumë gjasa të mos kërkonin punë kur ishin të papunë (44%), sesa ata mes moshës 25 dhe 35 vjeç (12%). Grupmosha e fundit ishte më shpesh e angazhuar në punë me orar të plotë (48%) sesa grupmosha 18–24 vjeç (21%).

Të rinjtë që morën pjesë në grupet e fokusit ishin kryesisht të papunë (21), ndërsa 17 ishin të punësuar. Më shumë pjesëmarrës serbë të grupeve të fokusit ishin të punësuar sesa pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës.

Figura 34.


Aktivitetet aktuale të punësimit të të rinjve, sipas gjinisë dhe moshës



Arsyeja më e zakonshme e përmendur pse të rinjtë e papunë nuk kërkonin punë ishte se dëshironin të mbaronin arsimin e tyre së pari (71%, rritje prej 23 për qind). Një pjesë tjetër prej 19% e të anketuarve përmendën përgjegjësitë familjare si arsye për të mos kërkuar punë. Në vitin 2018, të rinjtë përmendën më shpesh përgjegjësitë familjare (25%) dhe mospasjen e kualifikimit të duhur (12%) si arsyet për të mos kërkuar punë.


Figura 35.

Arsyet për të mos kërkuar punë



Zbërthimi sipas përkatësisë etnike tregoi se shumica e të anketuarve serbë të Kosovës përmendën se dëshironin të përfundonin arsimin e tyre së pari si arsye për të mos kërkuar punë (97%). Më pak se dy të tretat e shqiptarëve të Kosovës deklaruan të njëjtën gjë (60%), ndërsa gati një në katër (22%) përmendën përgjegjësitë familjare si arsye për të mos kërkuar punë. Shumica e të anketuarve që vijnë nga komunitete të tjera jo-shumicë (64%) gjithashtu përmendën përgjegjësitë familjare si arsye për të mos u përpjekur të sigurojnë punë, ndërsa 14% përmendën çështjet shëndetësore si arsye.


Figura 36.
Arsyet për të mos kërkuar punë,
sipas përkatësisë etnike



Për më tepër, mungesa e shpresës për një të ardhme më të mirë dhe mungesa e perspektivës në përgjithësi u përmendën nga pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës të grupeve të fokusit, si arsye pse disa të rinj në Kosovë kanë humbur motivimin e tyre për të kërkuar punë.

Gati tre në katër të rinj të papunë marrin mbështetje nga prindërit e tyre (71%), 42% të tjerë marrin mbështetje nga anëtarët e tjerë të familjes. Krahasuar me vitin 2018, mbështetja nga prindërit është rritur me 16pp në 2020. Nga ana tjetër, më shumë të rinj merrnin mbështetje nga të afërmit ose shokët që jetojnë jashtë në vitin 2018 (19%), krahasuar me vitin 2020 (7%). Për më tepër, vetëm 2% raportuan se kishin marrë ndihmë nga fonde publike dhe disa pjesëmarrës në grupet e fokusit i kritikuan institucionet e Kosovës për mungesën e mbështetjes financiare për studentët dhe deklaruan se edhe për ata që morën mbështetje, nuk ishte e mjaftueshme për të përballuar jetesën e tyre.

Figura 37.
Si e mbajnë veten financiarisht të rinjtë e papunë



Atyre që raportuan se ishin të papunë në vitin 2020 iu paraqitën edhe një sërë pyetjesh të mëtejshme për ta kuptuar më mirë situatën e tyre.

Një faktor që spikati ishte se rreth tre në katër respondentë raportuan se nuk kishin përvojë pune (77% kundrejt 67% në 2018). Shumica e të anketuarve i kanë lënë punët e tyre të mëparshme sepse ishin në pozita afatshkurtra (43%) ose sepse pozitat e tyre ishin ndërprerë (28%). Në vitin 2018, më shumë të rinj përmendën ndërprerjen (38%) dhe më pak angazhime afatshkurtra (31%).

Gjetjet e grupeve të fokusit nënvizuan çështjen e përvojës në punë. Shumë të rinj, shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës, mendonin se si fillestar në karrierë ishte gati e pamundur të sigurohej një vend pune për shkak të pritjeve të mëdha nga punëdhënësit për përvojën e punës. U theksua edhe mungesa e mundësive për praktikë si një faktor frenues i zhvillimit të hershëm të karrierës në Kosovë posaçërisht nga shqiptarët e Kosovës.

“ata që sapo e kanë mbaruar shkollën e mesme nuk mund të kenë përvojë. Si ta fitojnë? Pra, ky është problemi kyç, të gjithë po kërkojnë përvojë dhe askush nuk dëshiron të punësojë njerëz në mënyrë që ata të mund të marrin përvojë.
(Vajzë e re serbe e Kosovës (19) nga Graçanica)

Teksa dy të tretat e të rinjve që morën pjesë në anketë pohuan se nuk e kanë refuzuar kurrë një punë, gati një e treta pranuan se e kanë bërë (30%, krahasuar me 21% në 2018). Kur u pyetën nëse të anketuarit e papunë do të konsideronin një punë me të hyra të ulëta, opinionet ndryshonin pasi 34% u përgjigjën me ndoshta, 32% me po dhe 29% me jo.

Figura 38.
Përvoja e punës së të rinjve të papunë




Figura 39.
Arsyet pse nuk punojnë më në punët e mëparshme




Figura 40.
Të papunë që e kanë refuzuar një punë






Figura 41.
Të papunë që do ta konsideronin një punë me të hyra të ulëta




Rreth dy në pesë të anketuar të rinj që deklaruan se ishin të papunë por që kërkonin punë, deklaruan se kishin kërkuar për më shumë se një vit (42%). Një pjesë tjetër prej 27% raportuan se kishin kërkuar deri në tre muaj, ndërsa 18% raportuan se kishin kërkuar për një vit.

Figura 42.
Kohëzgjatja e kërkimit të punësimit



Të rinjtë e papunë i identifikuan **vështirësinë kryesore për gjetjen e vendeve të punës** me mungesën e vendeve të punës/pozitave të disponueshme (33% kundrejt 43% në 2018), korrupsionin (32% kundrejt 42% në 2018), nepotizmin në procesin e rekrutimit (31% kundrejt 37% në 2019) dhe mungesën e kualifikimeve profesionale ose nivelit të kërkuar të përvojës së punës (nga 27% secila kundrejt 41% dhe 38% përkatësisht në 2018). Siç tregojnë gjetjet, teksa arsyet kryesore për vështirësitë në gjetjen e punës mbetën të njëjtat, në 2018 ato u përmendën nga përqindje më të larta të të anketuarve.

Figura 43.
Arsyet e vështirësive në sigurimin e punësimit



Pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës të grupeve të fokusit theksuan çështjen e nepotizmit dhe proceset e padrejta të rekrutimit, ndërsa disa përmendën edhe probleme me diskriminimin


“Vetëm vitin e shkuar aplikova në 40 vende të lira pune, isha në katër intervista, 2-3 u përgjigjën se po e verifikonin aplikimin tim. Në të gjitha intervistat e mia, u përmend shama ime.”(Grua e re shqiptare (30) nga Kaçaniku)

Një çështje tjetër shqetësuese është se më shumë se një në tre të rinj të papunë **nuk ishin aspak të sigurt se do të gjenin punë brenda gjashtë muajve të ardhshëm** (35% kundrejt 38% në 2018). Gjetjet gjithashtu treguan se rreth dy në pesë vajza të reja nuk ishin aspak të sigurta (39%), ndërsa pak më pak djem të rinj shprehën të njëjtën gjë (31%).

Një e treta kishin pak besim (33% kundrejt 36% në 2018) dhe 25% ndiheshin deri diku të sigurt për gjetjen e punës në gjashtë muajt e ardhshëm. Vetëm 1% u shprehën të bindur se do të gjejnë punë brenda gjashtë muajve të ardhshëm, ndërsa në vitin 2018, 4% u shprehën si shumë të sigurt.

Figura 44.

Besimi i të anketuarve për gjetjen e një pune në gjashtë muajt e ardhshëm




Sektori publik ende perceptohej si punëdhënësi potencial më i favorshëm për të rinjtë e papunë në Kosovë në vitin 2020. Më shumë se dy të tretat e të anketuarve të papunë deklaruan preferencën për të punuar në sektorin publik (69% kundrejt 62% në 2018) në krahasim me sektorin privat (11%), OJQ (5%) ose vetëpunësim (1%).

Pjesa e të rinjve që treguan preferencën ndaj sektorit privat ose vetë-punësimit ka rënë përkatësisht me -13pp dhe -4pp, krahasuar me gjetjet e vitit 2018. Teksa disa pjesëmarrës të grupeve të fokusit theksuan se nepotizmi dhe korrupsioni ishin çështje në sektorin publik dhe privat, disa pjesëmarrës serbë të Kosovës mendonin se procesi i rekrutimit në institucionet publike ishte më i drejtë krahasuar me atë privat dhe prandaj ishte një punëdhënës më i dëshiruar.

Figura 45.


Preferenca e sektorit të punës



Kur të anketuarit e papunë u pyetën nëse kanë kryer ndonjë punë të papaguar për të ndihmuar organizatat, klubet ose grupet e komuniteteve, 37% nuk janë përgjigjur në këtë pyetje. Rreth 21% janë angazhuar në fushata, nga 15% kanë ndihmuar për organizimin e eventeve/aktiviteteve ose kanë ndihmuar me edukim, trajnim ose stërvitje. 12% të tjerë janë angazhuar në aktivitete për të përfaqësuar komunitetin e tyre.


Në përgjithësi, kur krahason gjetjet e të dhënave nga viti 2018 dhe 2020 për këtë çështje, gatishmëria e përgjithshme e të rinjve **për t'u përfshirë në aktivitete vullnetare** ka rënë.

Figura 46.
Preferenca e sektorit të punës



Gjetjet e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se më shumë djem janë angazhuar në fushatë (27%), duke ndihmuar në organizimin e eventeve ose aktiviteteve (17%) ose përfaqësimin e komunitetit të tyre (16%) sesa vajzat (16%, 13% dhe 9% përkatësisht). Nga ana tjetër, vajzat kanë qenë më shpesh të përfshira në arsim, aftësim ose stërvitje (17%) krahasuar me djemtë (13%). Teksa të dhënat zbuluan se 21% e të dy grupmoshave angazhohen në fushatë, llojet e tjera të punës vullnetare ishin më të zakonshme në mesin e të anketuarve më të vjetër mes moshës 25 deri 35 vjeç krahasuar me ata mes moshës 18 deri 24 vjeç.


Figura 47.
Angazhimi në aktivitete të papaguara për të ndihmuar organizatat, klubet, grupet ose komunitetet, sipas gjinisë dhe moshës



Gjetjet e anketës më tej tregojnë se të anketuarit serbë të Kosovës ishin më aktivë në lidhje me fushatat (36%), duke ndihmuar në organizimin e eventeve dhe aktiviteteve (21%) dhe përfaqësimin e komunitetit të tyre (26%) krahasuar me shqiptarët e Kosovës ose komunitetet e tjera jo-shumicë. Shqiptarët e Kosovës përmendën më shpesh angazhimin në arsim, aftësim ose stërvitje (18%) krahasuar me serbët e Kosovës (14%) dhe komunitetet e tjera jo-shumicë (12%). (Ju lutem vini re, pjesa tjetër prej 43% e komuniteteve të tjera jo-shumicë që zgjodhën "tjetër" më së shpeshti specifikuan se nuk marrin pjesë në asnjë lloj pune vullnetare/të papaguar).

Figura 48.

Angazhimi në aktivitete të papaguara për të ndihmuar organizatat, klubet, grupet ose komunitetet, sipas përkatësisë etnike




Teksa të anketuarit në grupet e fokusit nuk u pyetën në mënyrë specifike për aktivitetet vullnetare ose të papaguara, disa nga pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës të grupeve të fokusit përmendën angazhimin në punë vullnetare dhe raportuan se kishin siguruar punë pagesë për të njëjtën organizatë pas disa kohësh.

Mes të anketuarve që ishin të punësuar në kohën e intervistës, shumica punonin në sektorin privat (57%, ulje prej -9 pp), ndërsa një e treta ishin të angazhuar në sektorin publik (33%, rritje prej 12 pp). Pesë për qind punonin për OJQ (rritje prej 2 pp) ose ishin të vetë-punësuar (ulje prej -5pp).


Figura 49.

Lloji i vendit të punës të të anketuarve të punësuar



Gjetja e një pune të përshtatshme për kualifikimet dhe shkathtësitë e të anketuarve ka qenë sfida më e madhe për 49% të atyre të rinjve që ishin aktualisht të punësuar në kohën e intervistës (rritje 5pp krahasuar me 2018), 28% të tjerë mendonin se përmbushja e kriterëve për sa i përket përvojës në punë ishte sfida më e madhe (rënie prej -7 pp) dhe 18% përmendën kalimin e procesit të rekrutimit (rënie prej -8 pp). Mungesa e përvojës në punë dhe nepotizmi u theksuan edhe nga pjesëmarrësit e grupeve të fokusit.


Figura 50.
Sfidat ndaj gjetjes së punës



Kur hedhim një vështrim më të afërt mbi sfidat ndaj gjetjes së punës të zërthyer sipas gjinisë, gjetjet tregojnë se pak më shumë meshkuj (51%) e përmendën si sfida gjetjen e një pune të përshtatshme për kualifikimet e tyre dhe përmbushjen e kriterëve për sa i përket përvojës së punës (30%), krahasuar me femrat (përkatesisht 46% dhe 25%). Për dallim, më shumë femra përmendën kalimin e procesit të rekrutimit si sfida (20%) sesa meshkujt (16%).

Vëzhgime të ngjashme bëhen edhe kur analizohen gjetjet sipas përkatësisë etnike; më shumë shqiptarë të Kosovës përmendën gjetjen e një pune të përshtatshme për kualifikimet e tyre (54%) dhe përmbushjen e kriterëve për sa i përket përvojës së punës (29%), krahasuar me serbët e Kosovës (45% dhe 28% përkatësisht) ose komunitetet e tjera jo-shumicë (40% dhe 27% përkatësisht). Më shumë serbë të Kosovës e përmendën si sfida kalimin e procesit të rekrutimit (21%) sesa shqiptarë të Kosovës (21%) ose komunitete të tjera jo-shumicë (13%).

Figura 51.
Sfidat ndaj gjetjes së punës, sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike



4.5 ÇËSHTJET NDËR-ETNIKE, FETARE DHE TË SIGURISË

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (21%) mendonin se **marrëdhëniet ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Kosovë janë të tensionuara**, por vitet e fundit kanë ndodhur përmirësime të konsiderueshme. Një pjesë tjetër pre 16% kanë parë disa përmirësime. Në përgjithësi, 17% dhe 16% përkatësisht i përjetonin marrëdhëniet si "aspak të tensionuara" ose "jo aq të tensionuara", nga ana tjetër, 15% mendonin se marrëdhëniet janë të tensionuara dhe do të vazhdojnë të jenë të tilla.


Megjithëse të dhënat e zërthyera sipas gjinisë në marrëdhëniet ndëretnike nuk treguan shumë ndryshime, të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike zbuluan dallime të konsiderueshme. Për shembull, **teksa 27% e shqiptarëve të Kosovës mendonin se marrëdhëniet nuk ishin aspak të tensionuara, vetëm 1% e serbëve të Kosovës deklaruan të njëjtën gjë.** Në mënyrë të konsiderueshme më shumë serbë të Kosovës i perceptonin marrëdhëniet si të tensionuara ndërsa janë bërë përmirësime të konsiderueshme (29%) krahasuar me shqiptarët e Kosovës (10%). Sidoqoftë, 19% e shqiptarëve të Kosovës dhe 14% e serbëve të Kosovës ende mendonin se marrëdhëniet ishin të tensionuara dhe do të vazhdojnë të jenë të tilla.

Diskutimet në grupet e fokusit zbuluan se **çështjet e së kaluarës** ende luajnë një rol në këtë kontekst. Pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës njësoj përmendën **ndikimin e vazhdueshëm të prindërve dhe mësimdhënësve** (brezat e vjetër) të cilët ua kaluan të rinjve në Kosovë paragjykimet dhe mosbesimin e tyre. Sidoqoftë, disa nga pjesëmarrësit e rinj të të dy etnive mendonin se marrëdhëniet mes të rinjve janë përmirësuar dhe se në përgjithësi ka pasur progres.

Më së shpeshti, **ata që kishin kontakte personale me etninë tjetër, kishin pikëpamje më të mira ndaj njëri-tjetrit.** Disa pjesëmarrës serbë të Kosovës kurrë nuk kanë bashkëvepruar me një person shqiptar të Kosovës, ata gjithashtu deklaruan se media, përmes raportimit spekulativ, shpesh pengonte ndërtimin e besimit mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Disa nga pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës gjithashtu theksuan se si pjesëmarrja në aktivitete të përbashkëta ka ndryshuar/zvogëluar paragjykimet e tyre.


Figura 52.

Vlerësimi i marrëdhënieve mes të rinjve shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës



Kur krahasohen rezultatet e diskutuara më lart nga viti 2020 me rezultatet e përgjithshme nga viti 2018, mund të vërehet se **në vitin 2020 më pak të anketuar deklaruan se marrëdhëniet janë të tensionuara** ndërsa janë bërë disa përmirësime në vitet e fundit (21%) krahasuar me 2018 (28%). Sidoqoftë, më shumë të anketuar deklaruan se marrëdhëniet nuk janë “aspak të tensionuara” ose “jo aq të tensionuara” në vitin 2020 (përkatësisht 17% dhe 16%) krahasuar me 2018 (përkatësisht 7% dhe 10%). Mjaft më pak të anketuar në vitin 2020 besonin se marrëdhëniet janë të tensionuara dhe do të vazhdojnë të jenë të tilla (15%) krahasuar me gjetjet e vitit 2018 (27%).

Figura 53.
Preferenca e sektorit të punës




Në përgjithësi, opinionet që kishin të anketuarit ndaj marrëdhënies së shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës bazoheshin në përvojat personale, sipas 35% të të rinjve që morën pjesë në këtë studim. Pothuajse një e treta raportuan se opinionin e tyre e kishin të bazuar në raportimin mediatik (29%), ndërsa 23% deklaruan se e kishin të bazuar opinionin e tyre në histori dhe përvoja nga miqtë dhe të afërmit. Vetëm 10% përmendën historinë e kohëve të fundit si bazë për opinionet e tyre. Më shumë meshkuj të rinj deklaruan se vlerësimin e marrëdhënies mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës e bazonin në përvojat e tyre (38%), krahasuar me femrat e reja (31%).

Anasjelltas, më shumë femra të reja deklaruan se e bazonin vlerësimin e tyre në histori dhe përvoja nga miqtë dhe të afërmit (28%), krahasuar me meshkujt e rinj (19%). Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve të të dy gjinive përmendën raportimin e mediave si bazë të vlerësimit të tyre për marrëdhëniet mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës (31% femra, 27% meshkuj). Vlerësimi i bazuar në përvojat e tyre personale ishte pak më i zakonshëm në mesin e të anketuarve më të rritur (25–35 vjeç) kur krahasohet me ata më të vegjël (18 deri 23 vjeç).

Kur i vështrojmë më nga afër të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike, u vu re se serbët e Kosovës më rrallë e bazonin vlerësimin e tyre në raportimin mediatik (11%), kur krahasohen me komunitetet e tjera jo-shumicë (51%) dhe shqiptarët e Kosovës (33%). Pothuajse gjysma e serbëve të Kosovës e bazonin vlerësimin e tyre në përvojat personale (46%), ndërsa vetëm 30% e shqiptarëve të Kosovës bënë të njëjtën gjë.

Figura 54.

Baza për vlerësimin e marrëdhënieve ndërmjet të rinjve shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës



Kishte vlerësime të ndryshme të **marrëdhënieve me të rinjtë që vijnë nga komunitete të tjera jo-shumicë**¹³. Rreth një në tre i ka përjetuar si jo të tensionuara (35%), një pjesë tjetër prej 17% mendonte se nuk ishin aq të tensionuara, ndërsa 15% i perceptonin marrëdhëniet si të tensionuara me përmirësime të konsiderueshme dhe 12% i vlerësonin si të tensionuara me disa përmirësime në vitet e fundit. Vetëm 6% mendonin se këto marrëdhënie ishin të tensionuara dhe ka të ngjarë të vazhdonin të ishin të tilla.

Kur analizohen **rezultatet e të dhënave të zbërthyer sipas përkatësisë etnike**, u vu re se mbi gjysma e të rinjve shqiptarë të Kosovës i perceptonin marrëdhëniet me komunitetet e tjera jo-shumicë si aspak të tensionuara (53%). Të anketuarit që vijnë nga komunitete të tjera jo-shumicë gjithashtu kryesisht mendonin se marrëdhëniet me të tjerët nuk ishin aspak të tensionuara (53%). Të rinjtë serbë të Kosovës u dalluan në këtë drejtim me vetëm 1% që deklaruan se marrëdhëniet nuk ishin aspak të tensionuara. Mbi një e treta vlerësoi marrëdhëniet me komunitetet e tjera jo-shumicë si të tensionuara me përmirësime të konsiderueshme (34%), ndërsa 24% i përjetonin si të tensionuara me disa përmirësime në vitet e fundit.

Pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës në grupet e fokusit mendonin se diskriminimi dhe paragjykimet ishin të përhapura ndaj romëve, ashkalive dhe egjiptasve në Kosovë. Teksa shumë mendonin se marrëdhëniet e tyre personale me këto komunitete jo-shumicë ishin të mira, ata përjetonin që paragjykimet e brezave të moshuar shqiptarë të Kosovës kishin efekte të mëdha në mënyrën se si disa nga të rinjtë i shikonin anëtarët e komuniteteve jo-shumicë.


[...] në klasën e 7-të, ne kishim një djalë në klasën tonë i cili vinte nga komuniteti rom dhe kur erdhi në klasën tonë – qëndroi aty për një ose dy vjet. Ai ishte shumë i diskriminuar, i ngacmuar, për mënyrën si vishej, rrugës ai ishte gjithmonë vetëm, por në të njëjtën kohë askush nuk rrinte me të. Një ditë, një mësuesi më tha të uleshja pranë tij; [...] pastaj unë gjithashtu u ngacmova dhe ofendova sepse isha ulur pranë tij.

(Vajzë e re shqiptare e Kosovës (17) nga Prishtina)

¹³Referuar anëtarëve të komunitetit rom, ashkali, turk dhe egjiptas

Figura 55.

Vlerësimi i marrëdhënieve ndërmjet të rinjve shqiptarë të Kosovës dhe serbë të Kosovës dhe komuniteteve të tjera jo-shumicë



Më pas, të anketuarit u pyetën për **arsyet kryesore që kontribuojnë në marrëdhëniet e tensionuara ndërmjet etnive të ndryshme** në Kosovë. Një në tre përmendën ndikimin e kujtimeve të konfliktit si arsyen kryesore (33%), ndërsa gati po aq deklaruan ndikimin nga gjeneratat e vjetra që përjetuan konfliktin (29%).


Të anketuarit mes moshës 25 deri 35 vjeç mendonin më shpesh se ndikimi i kujtimeve të konfliktit ishte një arsye kontribuese për marrëdhëniet e tensionuara (38%), sesa ata që i përkisnin grupmoshës më të re (27%).

Teksa 27% e të anketuarve që vijnë nga komunitete të tjera jo-shumicë dhe 13% e shqiptarëve të Kosovës e shikonin ndikimin e qeverisë serbe si arsyen kryesore për marrëdhëniet e tensionuara, askush nga të anketuarit serbë të Kosovës nuk e përmendi këtë faktor.

Gjetjet e grupeve të fokusit në përgjithësi konfirmuan gjetjet e anketës në lidhje me këtë çështje. Siç u diskutua më lart, ndikimi i brezit të vjetër dhe paragjykimet e tyre u deklaruan të ishin një nga faktorët kryesorë që kontribuojnë në paragjykimet e vazhdueshme të të rinjve nga etni të ndryshme ndaj njëri-tjetrit.

Figura 56.

Arsyet kryesore që kontribuojnë në marrëdhëniet e tensionuara ndërmjet etnive të ndryshme në Kosovë



Anketa hulumtoi edhe opinionet e të rinjve **se si mund të përmirësohen marrëdhëniet mes serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës**. Më shumë se dy në pesë të anketuar përmendën si zgjidhje rritjen e tolerancës dhe mirëkuptimit për njëri-tjetrin (42%), ndërsa 30% përmendën sigurimin e mundësive të barabarta për pjesëmarrje në proceset e vazhdueshme politike, ekonomike dhe sociale. 18% të tjerë mendonin se pjesëmarrja në aktivitete të përbashkëta mund të ndihmonte në përmirësimin e marrëdhënieve. Mësimi i gjuhëve të njëri-tjetrit u përmend gjithashtu nga 18%.

Gjatë Studimit të Rinisë 2018, më shumë të rinj përmendën qasjen edukuese (41%), programet e edukimit ndërmjet grupeve (37%), aktivitetet e përbashkëta (25%) dhe shkollat e integruara (19%) si sugjerime për përmirësim. Vetëm 23% përmendën rritjen e tolerancës dhe mirëkuptimit në vitin 2018.

Figura 57.

Si mund të përmirësohen marrëdhëniet mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës




Kur u konsultuan **rezultatet e të dhënave të zbërthyera sipas gjinisë**, u vu re se më shumë meshkuj të rinj përmendnin rritjen e tolerancës dhe mirëkuptimit (46%) sesa femrat e reja (37%). Nga ana tjetër, 20% e femrave të reja mendonin se një qasje edukative mund të ndihmonte në përmirësimin e marrëdhënieve (20%), ndërsa vetëm 13% e të meshkujve të rinj e mendonin të njëjtën gjë. Duhet të theksohet se të rinjtë serbë të Kosovës e theksuan veçanërisht të mësuarit e gjuhëve të njëri-tjetrit (45%) sesa shqiptarët e Kosovës (3%). Anasjelltas, më shumë shqiptarë të Kosovës e përmendën qasjen edukative (30%) ose programet e përbashkëta arsimore ndërmjet grupeve (19%) krahasuar me serbët e Kosovës (përkatesisht 2% dhe 3%).

Diskutimet në grupet e fokusit ofruan njohuri të vlefshme edhe për këtë çështje. Disa pjesëmarrës përmendën se kishin pasur paragjykime, por frekuentimi i shkollave verore dhe programeve të përbashkëta rimore u ka ndihmuar që të shihnin njëri-tjetrin si të barabartë.

Unë kam shokë serbë dhe kemi një marrëdhënie miqësore dhe kjo u bë e mundur për shkak të faktit se ishim pjesë e shkollave verore dhe punëtorive; të gjithë duhet ta kenë këtë privilegj të përjetojnë këtë ndërveprim me të gjitha komunitetet e tjera në mënyrë që të bëhen miq. (Djalë i ri shqiptar i Kosovës (18) nga Prishtina)

Figura 58.

Si mund të përmirësohen marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës, sipas gjinisë, moshës dhe përkatesisë etnike




Feja

Tema tjetër i përkiste fesë dhe vlerësonte praktikën fetare të të rinjve në Kosovë. Njësoj si zbulimet e vitit 2018, rreth **një në tre të rinj deklaruan se e praktikonin fenë herë pas here** (34%). Më shumë të rinj deklaruan se e praktikojnë fenë rregullisht (28%) krahasuar me vitin 2018 (16%). Nga ana tjetër, 19% deklaruan se e praktikojnë fenë rrallë (24% në 2018) dhe 14% nuk e praktikojnë fare (16% në 2018).

Shumica e të anketuarve serbë të Kosovës të grupeve të fokusit deklaruan se ishin fetarë dhe deklaruan se feja luan një rol të konsiderueshëm në jetën e tyre. Teksa pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës në grupet e fokusit kishin opinione të ndryshme ndaj fesë, shumica deklaruan se nuk e praktikonin fenë por theksuan rëndësinë e respektimit të besimeve fetare të të tjerëve.


Figura 59.
Praktikimi i fesë




Më shumë se gjysma e të anketuarve të rinj deklaruan se pajtohen plotësisht me pikëpamjet fetare të prindërve të tyre (55%), ndërsa 29% pajtohen deri diku me pikëpamjet e prindërve të tyre. Një përqindje e rritur e të rinjve pajtohen plotësisht me pikëpamjet fetare të prindërve të tyre në krahasim me gjetjet e vitit 2018 (13pp).

Pajtimi me pikëpamjet fetare të mësimdhënësve, miqve dhe partnerit ka rënë në përgjithësi. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i të rinjve pajtohen plotësisht (14%) ose pajtohen deri diku (33%) me pikëpamjet fetare të mësimdhënësve të tyre, ndërsa 28% dhe 48% pajtohen plotësisht ose pajtohen deri diku me pikëpamjet e miqve të tyre përkatësisht. Ata mbi moshën 18 vjeç u pyetën gjithashtu nëse pajtoheshin me pikëpamjet fetare të partnerit/es të tyre dhe 43% nuk dhanë përgjigje, ndërsa 43% të tjerë pajtoheshin deri diku me pikëpamjet e partnerit/es të tyre.

Figura 60.
Pajtimi me pikëpamjet fetare të njerëzve të tjerë






Të rinjtë që morën pjesë në këtë anketë u pyetën gjithashtu për **ndikimin e komuniteteve fetare në zonën e tyre**. Gati një e treta deklaruan se ndikimi i komunitetit fetar në zonën e tyre ishte i konsiderueshëm, por jo vendimtar (31%), ndërsa 25% deklaruan se ndikimi i komunitetit fetar në zonën e tyre ishte i vogël. Rreth një në katër (24%) thanë se komuniteti fetar nuk kishte fare ndikim.

Nga ana tjetër, 12% deklaruan se komuniteti fetar kishte ndikim të madh në zonën ku jetonin, vlerë që e krahasuar me pulsën e të rinjve 2018 portretizon një rënie prej -6pp. Në vitin 2018, vetëm 11% deklaruan se komuniteti fetar nuk kishte fare ndikim në zonën e tyre.

Figura 61.
Ndikimi i komunitetit fetar në zonën e të rinjve




Ashtu si me rezultatet e anketës të Studimit për Rininë 2018, **ekstremizmi fetar** ishte përjetuar si shumë i përhapur ose deri diku i përhapur nga më shumë se gjysma e të anketuarve në vitin 2020 (53%). Megjithatë, më pak mendonin se ekstremizmi fetar ka qenë shumë i përhapur (6%), krahasuar me dy vjet më parë (13%).

Mbi një e treta e të rinjve mendonin se ekstremizmi politik ishte shumë i përhapur (37%, rritje prej 14 pp) dhe gati e njëjta përqindje e përshkruan si deri diku të përhapur (36%). Teksa 54% e të gjithë të rinjve e kishin përjetuar ekstremizmin nacionalist si shumë ose deri diku të përhapur në vitin 2018, në vitin 2020 kjo përqindje u rrit deri në 60%.

Pjesëmarrësit serbë të Kosovës në grupet e fokusit mendonin se ekstremizmi fetar nuk ishte i përhapur në Kosovë ose deklaruan se ekziston vetëm brenda bashkësisë islame. Pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës mendonin se ekstremizmi fetar në Kosovë ekziston deri diku.

Figura 62.


Perceptimi i të rinjve mbi prevalencën e llojeve të ndryshme të ekstremizmit në Kosovë



Raportimi nga media u referua më së shpeshti kur të rinjtë u pyetën se ku e bazojnë vlerësimin e tyre në lidhje me ekstremizmin në Kosovë (40%). Sidoqoftë, krahasuar me Studimin për Rininë 2018, kjo portretizon një rënie prej -16pp. Rezultatet e të dhënave nga viti 2020 zbuluan se dukshëm më shumë të rinj e kanë bazuar vlerësimin e tyre në përvojat personale (31%) sesa në vitin 2018 (13%). Rreth 18% deklaruan se vlerësimi i tyre ishte i bazuar në çka kishin dëgjuar (18%).

Figura 63.

Baza e vlerësimit në lidhje me nivelin e perceptuar të ekstremizmit fetar në Kosovë



Siguria


Anketa vlerësoi edhe nëse të rinjtë në Kosovë ndiheshin të sigurt në lagjet e tyre, shkollat, vendet e punës dhe kur dilnin. Të dhënat krahasuese mes Studimit për Rininë 2018 dhe 2020 treguan se, në përgjithësi, **të rinjtë ndihen më pozitivë për sigurinë**: 86% raportuan se ndiheshin shumë të sigurt ose deri diku të sigurt në lagjen e tyre (ritje prej 14 pp), 78% deklaruan se ndiheshin shumë ose deri diku të sigurt kur dilnin (11 pp), 68% ndiheshin shumë të sigurt ose deri diku të sigurt në shkollë (-2 pp), dhe 54% ndiheshin shumë të sigurt në vendin e tyre të punës (-1pp). Për më tepër, teksa në vitin 2018 më shumë të rinj raportuan se ndiheshin deri diku të sigurt në këto vende, në vitin 2020 kishte më shumë që raportuan se ndiheshin shumë të sigurt.

Diskutimet në grupet e fokusit zbuluan se teksta shumë deklaruan se ndiheshin të sigurt në mjediset e tyre të afërta, disa nga pjesëmarrësit serbë të Kosovës deklaruan se nuk ndiheshin të sigurt. Prevalenca e krimeve të tilla si vjedhja, dhuna dhe ngacmimet seksuale kanë kontribuar në mungesën e sigurisë sipas të anketuarve serbë të Kosovës.

Për më tepër, koha e gjatë për të marrë përgjigje dhe e përpunimit nga policia të rasteve të tilla, shoqëruar me dënime të pamjaftueshme, u përmendën si arsye shtesë për të mos u ndjerë të sigurt nga disa pjesëmarrës. Pjesëmarrësit shqiptarë të Kosovës në grupet e fokusit që i përkisnin komunitetit LGBTQI raportuan se ndiheshin më pak të sigurt për shkak të të qenurit pjesë e një grupi të marginalizuar.

Për sa i përket vjedhjes, ngacmimit seksual, ngacmimit verbal për të degraduar një person për shkak të gjinisë ose moshës së tij/saj – ato ndodhin mjaft shpesh. [...] Unë besoj se ky lloj ngacmimi është mjaft i përhapur dhe raportimi nuk merret seriozisht. (Vajzë e re shqiptare e Kosovës (22) nga Deçani)

Figura 64.
Ndjenja e sigurisë e të rinjve në Kosovë



Gjetjet e anketës zbuluan edhe se të anketuarit e të dy gjinive ndiheshin më të sigurt në vitin 2020 në krahasim me vitin 2018. Sidoqoftë, mes të anketuarve meshkujt ndiheshin më të sigurt se femrat në zona të ndryshme. Në përgjithësi, më shumë femra (57%, rritje prej 15pp) dhe meshkuj (55%, rritje 16pp) deklaruan se ndihen shumë të sigurt në lagjen e tyre krahasuar me dy vjet më parë. Përqindja e atyre që ndihen shumë të sigurt në shkollë ose kur dalin jashtë është rritur për meshkujt me 11p dhe 24pp dhe me 8pp dhe 11pp për femrat. U dallua që ndërsa shumë më tepër meshkuj raportuan se ndiheshin shumë të sigurt në vendin e tyre të punës në vitin 2020 (rritje prej 19 për qind), rezultati për femrat pothuajse mbeti i njëjtë (rritje prej 2 për qind). Sidoqoftë, duhet të theksohet se shumica e femrave nuk kanë dhënë përgjigje në lidhje me sigurinë në vendin e punës kryesisht për shkak të një shkalle më të lartë të papunësisë.

Figura 65.
Ndjenja e sigurisë e të rinjve në Kosovë







Figura 66.
Ndjenja e sigurisë e të rinjve në Kosovë



Shumica e të rinjve mendonin se institucionet e nivelit qendror të Kosovës po bënin sa duhet (24%, një rritje prej 10 për qind krahasuar me 2018) ose po bënin sa duhet deri diku (38%) në mënyrë që të rrisin ndjenjën e sigurisë në lagjen e tyre në vitin 2020. Rreth 63% raportuan të njëjtën gjë në lidhje me rrugët, 59% në lidhje me shkollën e tyre, dhe 53% në lidhje me vendin e tyre të punës (mjaftueshëm dhe mjaftueshëm deri diku të kombinuar). Sidoqoftë, duhet të theksohet se rreth një në tre mendonin se institucionet e nivelit qendror nuk po bëjnë sa duhet për të rritur ndjenjën e sigurisë në rrugë (31%) ose në lagjen e tyre (30%), në shkollat e tyre (25%) dhe vendin e punës (19%).

Figura 67.
Perceptimi nëse institucionet e nivelit qendror të Kosovës po bëjnë mjaftueshëm që të rinjtë të ndihen të sigurt në vende të ndryshme






Shumica e të rinjve mendonin se institucionet e nivelit qendror të Kosovës po bënin sa duhet (24%, një rritje prej 10 për qind krahasuar me 2018) ose po bënin sa duhet deri diku (38%) në mënyrë që të rrisin ndjenjën e sigurisë në lagjen e tyre në vitin 2020. Rreth 63% raportuan të njëjtën gjë në lidhje me rrugët, 59% në lidhje me shkollën e tyre, dhe 53% në lidhje me vendin e tyre të punës (mjaftueshëm dhe mjaftueshëm deri diku të kombinuar). Sidoqoftë, duhet të theksohet se rreth një në tre mendonin se institucionet e nivelit qendror nuk po bëjnë sa duhet për të rritur ndjenjën e sigurisë në rrugë (31%) ose në lagjen e tyre (30%), në shkollat e tyre (25%) dhe vendin e punës (19%).

4.6 PRITJET PËR TË ARDHMEN

Në përgjithësi, pritjet për të ardhmen nga të rinjtë në Kosovë u dukën mjaft të ulëta. Ashtu si me studimin e vitit 2018, rreth **dy në pesë të anketuar mendonin se ishte deri diku e pamundur që të rinjtë në Kosovë të kishin një jetë më të mirë brenda rreth pesë vjetësh** (40%). Rreth 12% perceptonin se kjo nuk ka aspak gjasa të ndodhë.

Teksa më pak mendonin se një jetë më e mirë do të ishte deri diku e mundshme (31% kundrejt 44% në 2018), pak më shumë deklaruan se jeta do të ishte shumë më mirë për pesë vjet (10%, rritje prej 6pp).


Figura 68.
Gjasat e perceptuara që të rinjtë në Kosovë të kenë një jetë më të mirë pas pesë vjetësh



Grupmosha më e re që mori pjesë në këtë anketë (14 deri 17 vjeç) shprehën më shumë shpresë; më shumë se gjysma e tyre mendonin se kishte gjasa (36%) ose shumë gjasa (17%) që të rinjtë të kishin një jetë më të mirë brenda pesë vjetësh.

Figura 69.

Gjasat e perceptuara që të rinjtë në Kosovë të kenë një jetë më të mirë pas pesë vjetësh, sipas gjinisë, moshës




Në vitin 2020, të rinjtë në Kosovë u shfaqën veçanërisht pesimistë kur bëhet fjalë për përmirësimin e qasjes në punësim dhe situatën politike.

Rreth një në tre mendonin se përmirësimi i qasjes në punësim kishte deri diku pak gjasa (34%) ose shumë pak gjasa (29%). Përqindja e të anketuarve që mendonin se ky përmirësim do të kishte shumë pak gjasa në vitin 2018 ishte vetëm 5%.

Teksa 9% mendonin se përmirësimi i situatës politike kishte shumë pak gjasa në vitin 2018, në vitin 2020 kjo përqindje u rrit me 18pp (27%). Për më tepër, 39% dhe 21% përkatësisht mendonin se kishte deri diku pak gjasa ose shumë pak gjasa që situata socio-ekonomike të përmirësohej. Në vitin 2018 vetëm 9% mendonin se përmirësimi socio-ekonomik kishte shumë pak gjasa.

Shumica mendonin se **marrëdhëniet ndëretnike mes të rinjve kishin deri diku gjasa (45%) ose shumë të gjasa (10%) të përmirësoheshin**. Të dhënat sugjerojnë se opinionet duket se ndryshojnë në lidhje me gjasat e përmirësimeve të cilësisë së arsimit; 34% mendonin se ky përmirësim kishte deri diku gjasa dhe 35% mendonin se kishte deri diku pak gjasa. Pak më shumë të rinj mendonin se siguria dhe sigurimi kishin shumë gjasa të përmirësoheshin (18%) krahasuar me rezultatet e vitit 2018 (7%).

Figura 70.
Perceptimi i të rinjve mbi prevalencën e llojeve të ndryshme të ekstremizmit në Kosovë



Shumica e të gjithë pjesëmarrësve në grupet e fokusit, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjinia ose mosha e tyre, u pajtuan se pesë vjet ishte pak kohë për ndonjë ndryshim thelbësor ose zhvillim pozitiv në Kosovë. Teksa disa u shprehën negativisht, një numër i konsiderueshëm i të rinjve ndjenin shpresë për të ardhmen e të rinjve në Kosovë

“ Në pesë vitet e ardhshme dua të mendoj se do të bëhet më mirë, pasi ky është atdheu im dhe unë dua ta shoh të prosperojë. Shpresa vdes e fundit, pesë vjet nuk janë të mjaftueshme që shteti të zhvillohet, por shpresoj që hap pas hapi Kosova të jetë një vend i mirë për të jetuar. (I ri shqiptar i Kosovës (21) nga Gjilani)

”

KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET

Konkluzion

Gjetjet nga Studimi për Rininë 2020 treguan se të rinjtë në Kosovë mbeten të sfduar nga faktorë të ndryshëm në fusha të ndryshme të jetës së tyre. Shumë nga të rinjtë që morën pjesë në këtë hulumtim kishin **një këndvështrim pesimist për të ardhmen**, ata mendonin se vendi po shkonte në drejtimin e gabuar dhe raportuan mungesë të perspektivës personale. Kur krahason gjetjet me ato të vitit 2018, teksa disa nga problemet dhe çështjet kyçe mbetën të njëjtat, u vunë re edhe disa përmirësime.

Mungesa e mundësive për punë, situata e dobët ekonomike si dhe nepotizmi dhe korrupsioni ishin sfidat kryesore që veç kishin qenë të pranishme në vitin 2018 dhe duket se ishin përkeqësuar në vitin 2020. Shumica e të rinjve ishin të papunë (58%) dhe konsideronin, ose kishte gjasa ta konsideronin, migrimin në tre vitet e ardhshme (53%). Sidoqoftë, krahasuar me vitin 2018, kjo portretizon një rënie prej 5pp në të rinjtë që konsideronin largimin nga Kosova (58%), dhe mungesa e mundësive për punë mbeti arsyeja numër një për të aspiruar për të emigruar (67%). Ky do të vazhdojë të jetë shqetësimi kryesor duke pasur parasysh se më shumë se një në tre të rinj të papunë nuk ishin aspak të sigurt se ishin në gjendje të siguronin punësim brenda gjashtë muajve të ardhshëm.

Një tjetër gjetje e rëndësishme e këtij studimi ka të bëjë me shqetësimet në lidhje me **stresin dhe çështje të tjera të shëndetit mendor** të cilat ishin të përhapura në mesin e të rinjve në vitin 2020, dhe janë prekur qartë nga pasojat e pandemisë. Për më tepër, është shtuar përqindja e të rinjve të cilëve iu është dashur të mbështesnin të hyrat e familjes, gjë që ka çuar në përfundimin e përpjekjeve të tyre për arsimim, dhe mungesa e financave është perceptuar si pengesë e rëndësishme për vazhdimin e arsimit ose është përjetuar si sfidë gjatë angazhimit me arsimimin. Në lidhje me këtë, duhet të theksohet se janë të paktë ata që morën mbështetje financiare nga institucionet publike.

Pjesë të konsiderueshme të të rinjve nga komunitete të ndryshme ende i perceptonin marrëdhëniet ndëretnike si të tensionuara dhe shkaqet kryesore rrënjësore të përmendura kishin të bënin me **ndikimin e kujtimeve të konfliktit dhe ndikimin e gjeneratave të vjetra**. Për më tepër, në vitin 2018 dukshëm më shumë të anketuar mendonin se marrëdhëniet ishin të tensionuara dhe do të vazhdonin të ishin të tensionuara (27%) krahasuar me vitin 2020 (15%). Sidoqoftë, teksa shumë i perceptonin marrëdhëniet si të tensionuara, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve gjithashtu deklaruan se ka pasur përmirësime në vitet e fundit. **Rritja e tolerancës dhe mirëkuptimit për njëri-tjetrin ishte sugjerimi kryesor për përmirësimin e marrëdhënieve** sipas të anketuarve në vitin 2020. Gjetjet cilësore, nga ana tjetër, nënvizuan rëndësinë e aktiviteteve të përbashkëta siç janë shkollat e përbashkëta verore, punëtoritë dhe eventet sportive, dhe disa pjesëmarrës raportuan se i kishin ulur paragjykimet e tyre kur merrnin pjesë në nisma të tilla.

Kur u pyetën për **perspektivat e së ardhmes**, shumica e të rinjve në Kosovë mendonin se ndryshimi pozitiv nuk kishte gjasa të ndodhte brenda pesë viteve të ardhshme. Sidoqoftë, teksa shumica e pjesëmarrësve në grupet e fokusit u pajtuan se pesë vjet nuk është koha e mjaftueshme për përmirësime të konsiderueshme, një numër i konsiderueshëm i të rinjve ndjenin shpresë për të ardhmen e rinisë në Kosovë në vitet në vijim.

Së fundmi, **ndikimi i menjëhershëm dhe afatgjatë i krizës COVID-19** duhet të konsiderohet me kujdes kur reflektohet mbi çështjet kryesore të të rinjve dhe shqetësimet e zbuluara nga ky studim. Për

shembull, pa ndërhyrje të politikave dhe veprim të menjëhershëm, pandemia dhe recesioni ekonomik mund ta bjerrin më tej besimin mes komuniteteve, të forcojnë ndasitë ekzistuese dhe të ndezin ndasi të reja në nivelin brenda-grupit. Sfidat e reja ekonomike, liria e kufizuar e lëvizjes dhe ekspozimi intensiv përmes rrjeteve sociale ndaj propagandës polarizuese dhe gjuhës së urrejtjes, janë shtuar në numrin e frenuesve të njohur të kohezionit social në Kosovë (trashëgimia e konfliktit, narrativat antagonistë të konfliktit të ofruara në dy sisteme arsimore paralele, ndërveprimet jashtëzakonisht të kufizuara ndërmjet komuniteteve). Marrë në konsideratë gjithçka, ndikimi i pabarabartë i pandemisë sidomos lidhur me pabarazine gjinore dhe komunitetet e marginalizuara duhet të informojë reagimin gjithëpërfshirës të politikave ndaj kësaj krize. Përndryshe, marrë parasysht numrin e lartë të të rinjve dhe rolin e tyre për të ardhmen e Kosovës, do të jetë shumë e vështirë të realizohet rimëkëmbja ekonomike, shoqërore dhe politike, ndërkohë që duhet edhe të luftohet **për të mos lënë askënd pas**.

Rekomandime

Në raportin e Studimit për Rininë të vitit 2018 u ofruan një numër rekomandimesh që synonin adresimin e sfidave kryesore dhe konsolidimin e pozitës së të rinjve në Kosovë. Përkundër disa ndryshimeve inkurajuese në perceptimin e të rinjve, shumica e rekomandimeve janë ende relevante brenda kontekstit të gjetjeve të vitit 2020. Sfidat janë të shumëfishta, përfshirë punën për një shoqëri gjithëpërfshirëse ku të rinjtë mund të bashkëpunojnë për ta kuptuar më mirë njëri-tjetrin dhe për ta përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Sidoqoftë, shumë vajza dhe djem të rinj në Kosovë janë të përgatitur ta hedhin këtë hap të guximshëm për të punuar së bashku drejt një të ardhme më të mirë dhe të ndritshme. Prandaj, **ky studim i inkurajon palët kyçe të interesit që t'u japin përparësi shqetësimeve dhe interesave të të rinjve, si dhe bën sugjerimet e mëposhtme me qëllim të plotësisht të masave ekzistuese:**

Institucionet e Kosovës dhe autoritetet lokale inkurajohen që:

- Të promovohet zhvillimi ekonomik, të zvogëlohet varfëria dhe të zhvillohen strategji për t'i luftuar nepotizmin dhe korrupsionin.
- Të zbatohet "Plani i Veprimeve për Punësim të të Rinjve 2018–2022" i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për t'iu kundërvënë papunësisë tek të rinjtë. Komisioni Evropian në raportet e tij të viteve 2019 dhe 2020 e kritikoi drejtpërdrejt mungesën e zbatimit të hapave thelbësorë drejt përparimit në këtë drejtim.
- Të rritet mbështetja financiare për studentët që janë në arsim në mënyrë që të kundërveprohet ndaj niveleve të larta të braktisjes për shkak të mungesës së mjeteve financiare.
- Të adresohet punësimi informal, të krijohen kushte adekuate të punës, dhe të promovohet rekrutimi i drejtë në sektorët publik dhe privat.
- Të forcohet sektori privat, i cili punësoi shumicën e të rinjve në vitin 2020, përmes përmirësimeve në legjislacionin në fuqi. Kjo mund të bëhet për shembull përmes zbritjeve tatimore për punëdhënësit që punësojnë të rinj kosovarë ose përmes stimujve për punëdhënësit për të punësuar ose trajnuar të rinj, si dhe duke ofruar skema të subvencionimit të pagave që mbështesin punëdhënësit që punësojnë të rinj të papunë. Mund të përmirësohen edhe çështje të tjera të tilla si disponueshmëria e kredisë.

- Të sigurohet zbatim i shpejtë dhe i drejtë i projektligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike (Kuvendi i Kosovës, 2020 dhe Prishtina Insight 2020) për të kundërvepruar ndaj ndikimit që pati pandemia COVID-19 në bizneset në Kosovë, dhe më pas të ndihmohen të rinjtë për të mbajtur dhe siguruar punësim në kontekstin e një pandemie në vazhdim.
- Të zhvillohen ndërhyrje dhe programe të reja së bashku me palët e tjera relevante të interesit si OJQ-të, partitë politike dhe shkollat, të cilat synojnë uljen e stresit dhe adresimin e çështjeve të shëndetit mendor, si dhe problemet në lidhje me punën dhe mjedisin shkollor. Palët e interesit gjithashtu duhet të përfshijnë të rinjtë në proceset e vendimmarrjes në lidhje me dizajnin, planifikimin dhe zbatimin e vetë programeve. Siç është vërejtur në iniciativat e mëparshme, pjesëmarrja e të rinjve në të gjitha aktivitetet mund ta rrisë fuqizimin e tyre të qëndrueshëm si qytetarë aktivë.
- Të punohet për strategji të mëtejshme së bashku me palët e tjera relevante të interesit për të mbështetur migrimin ligjor dhe veçanërisht qarkor të të rinjve në Kosovë.
- Të bashkëpunohet më tej me komunat, shkollat, OJQ-të dhe Ministrinë e Arsimit për të përmirësuar kurrikulat arsimore, arsimin profesional, udhëzimet për karrierë dhe aktivitetet dhe programet e zhvillimit të shkathtësive. Teksa gjetjet e anketës treguan se më shumë të rinj ishin të kënaqur me cilësinë e arsimit të marrë në vitin 2020, çështje të tilla si metodat e vjetruara të mësimdhënies ende mbeten problematike.
- Në lidhje me pikën e mësipërme, Ministria e Arsimit duhet të konsiderojë përfitimet e reformimit të disa aspekteve kyçe të përmbajtjes dhe ofertës arsimore, duke përfshirë zhvillimin e një strategjie për mënyrën si të pajisen më mirë të rinjtë me shkathtësitë e shekullit 21 (njohuritë digjitale, bashkëpunimi, zgjidhja e problemeve, dhe të menduarit kritik). Kjo strategji duhet të synojë si kurrikulën ashtu edhe aftësimin e arsimtarëve, dhe të përpiqet të tërheqë fonde dhe mbështetje nga BE, UNDP, OSBE dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë të përqendruar në reformën arsimore.
- Në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian (2020b), të rritet ofrimi i arsimit dhe aftësimin profesional cilësor për profesionet e kërkuara. Kjo masë duhet të përdoret edhe si reagim ndaj ndikimit të krizës Covid-19 në mënyrë që të rinjtë të bëhen më të adaptueshëm ndaj ndryshimit të tregut të punës duke zhvilluar shkathtësitë përkatëse.
- T'u jepet prioritet masave për të përmirësuar qasjen në internet dhe pajisje TI për komunitetet e pa privileguara dhe të zhvillohen programe që targetojnë njohuritë digjitale për të rinjtë dhe arsimtarët.
- Të punohet së bashku me komunat, shkollat dhe palët e tjera të interesit në mënyrë që të zhvillohen më shumë mundësi për aktivitete të përbashkëta mes të rinjve me prejardhje të ndryshme etnike për të luftuar marrëdhëniet e tensionuara dhe paragjykimet. Shkollat e përbashkëta verore, punëtoritë dhe aktivitetet sportive u raportuan si të dobishme për tejkalimin e paragjykimeve ndaj të rinjve të komuniteteve të tjera.

Të rinjtë kosovarë inkurajohen që:

- Të përfshihen në programe dhe fushata kundër varfërisë, nepotizmit dhe korrupsionit, dhe të rrisin vetëdijësimin për ndikimin që këta faktorë kanë në jetën e të rinjve.
- Të marrin pjesë në takime, punëtori dhe debate me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin e kurrikulës dhe në përmirësimin vijues të cilësisë së arsimit.
- Të marrin pjesë në aktivitete të tilla si punëtori, evente sportive dhe shkolla verore së bashku me të rinj nga etni të tjera për të forcuar bashkëpunimin dhe miqësinë dhe për të kundërvepruar ndaj paragjykimeve për njëri-tjetrin.

- Të zhvillojnë rrjete arsimore dhe profesionale të të rinjve në të gjithë Kosovën për të ndarë ide dhe për të punuar së bashku drejt tejkalimit të çështjeve të përbashkëta.
- Të zhvillojnë një rrjet të ndërmjetësuesve të rinj të brendshëm për të lehtësuar dialogun dhe ndërtimin e konsensusit.

Aktorët ndërkombëtarë të pranishëm në Kosovë inkurajohen që:

- Të monitorohet nga afër dhe raportohet mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Punësim të të Rinjve (MPMS) dhe strategjive dhe planeve tjera për t'iu kundërvënë papunësisë tek të rinjtë.
- Të ofrohet mbështetje për institucionet e Kosovës përmes këshillave dhe ekspertizës në trajtimin e çështjeve dhe sfidave në lidhje me të rinjtë në vend.
- Të ofrohen, së bashku me palët e tjera të interesit, aktivitete të përbashkëta rinore për të nxitur bashkëpunimin ndëretnik dhe uljen e tensioneve në vend.
- Të punohet së bashku për të forcuar kapacitetet institucionale dhe të politikave për të integruar kohezionin shoqëror në planet e veprimit të Kosovës të orientuara në fuqizimin e të rinjve dhe grave. Për këtë qëllim, të zbatohen aktivitete që ofrojnë shkathtësi për zyrtarët dhe ndërtojnë mekanizma në të cilat institucionet mund të mbështeten kur ndërtojnë politika për të drejtat e të rinjve dhe integrimin gjinor.
- Të adresohet çështjet e përhapura në Kosovë, të tilla si nepotizmi dhe korrupsioni, përmes fushatave vetëdijesuese, dhe të inkurajohen të rinjtë të ndërmarrin veprime dhe të flasin kur dëshmojnë një sjellje të tillë.

REFERENCAT

Komisioni Evropian (2019) Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti për Kosovën 2019, marrë nga: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>, qasja e fundit më 22 dhjetor 2020

Komisioni Evropian (2020a), Tremujori Ekonomik i Vendeve Kandidate për BE dhe Kandidatëve të Mundshëm (CCEQ) Tremujori i tretë 2020, qasja e fundit më 22 dhjetor 2020, marrë nga: https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/economy-finance/tp044_en.pdf, qasja e fundit më 22 dhjetor 2020

Komisioni Evropian (2020b) Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti për Kosovën 2020, marrë nga: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf, qasja e fundit më 23 dhjetor 2020

Friedrich-Ebert-Stiftung e. V. (2019), Studimi për Rininë në Kosovë 2018/2019, marrë nga <http://library.fes.de/pdf-files/id-moe/15264.pdf>, qasja e fundit më 22 dhjetor 2020

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2019a) Shkalla e punësimit, marrë nga https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/askdata_Labour%20market_01%20Quarterly%20labour%20market_Pun%C3%ABsimi/tab1.1.px/?rxid=0b4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712/, qasja e fundit më 23 dhjetor 2020

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2019b) Të rinjtë NEET, marrë nga https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/askdata_Labour%20market_01%20Quarterly%20labour%20market_NEET/tab4.px/?rxid=0b4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712/, qasja e fundit më 23 dhjetor 2020

Kuvendi i Kosovës (2020), Kuvendi miratoi Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/shq/lajmi/kuvendi-miratoi-projektligjin-per-rimekembjen-26325/#>, qasja e fundit më 23 dhjetor 2020

OECD Et. Al. (2020), Kriza COVID-19 në Ballkanin Perëndimor: Ndikimi ekonomik, përgjigjet e politikave dhe zgjidhjet e qëndrueshme afatshkurtra, marrë nga: <http://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-Response-Western-Balkans.pdf>, qasja e fundit më 22 dhjetor 2020

OECD (2020a), Kriza COVID-19 në Kosovë; Maj 2020, marrë nga: <http://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo-archive.pdf>, qasja e fundit më 23 dhjetor 2020

OECD (2020b), Kriza COVID-19 në Kosovë; Nëntor 2020, marrë nga: <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo.pdf>, qasja e fundit më 23 dhjetor 2020

Pristina Insight (2020), Paketa e rimëkëmbjes ekonomike kalon në Kuvendin e Kosovës, marrë nga: <https://prishtinainsight.com/economic-recovery-package-passes-at-kosovo-assembly/>, qasja e fundit më 23 dhjetor 2020

OKB (2020), Informatë për politikat DESA # 67: Mbrojtja dhe mobilizimi i të rinjve në reagimet ndaj COVID-19, marrë nga <https://www.un.org/development/desa/youth/news/2020/05/covid-19/>, qasja e fundit më 10 shkurt 2021

UNICEF (2019), Analiza e Situatës së Grave dhe Fëmijëve në Kosovë, marrë nga: <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/1141/file/SITAN.pdf>, qasja e fundit më 22 dhjetor 2020

World Vision (2020), COVID-19 dhe Fëmijët: Si po e ndryshon pandemia globale jetën e fëmijëve në Shqipëri dhe Kosovë, marrë nga: <https://www.wvi.org/sites/default/files/2020-11/Country%20report-WA%26K%2019.11.2020.pdf>, qasja e fundit më 23 dhjetor 2020

Banka Botërore Et. Al. (2020), Trendet e Tregut të Punës në Ballkanin Perëndimor 2020, marrë nga: <https://wiiw.ac.at/western-balkans-labor-market-trends-2020-dlp-5300.pdf>, qasja e fundit më 22 dhjetor 2020

World Vision (2020), COVID-19 dhe Fëmijët: Si po e ndryshon pandemia globale jetën e fëmijëve në Shqipëri dhe Kosovë, një studim i metodës së përzier, marrë nga: <https://www.wvi.org/sites/default/files/2020-11/Country%20report-WA%26K%2019.11.2020.pdf>, qasja e fundit më 22 dhjetor 2020

ANEKS

Tabela 4. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 1, shqiptarë
Data: 20.11.2020 Ora: 17:30–19:45

| Gjinia | Niveli i arsimit | Mosha | Fshati/Qyteti | Komuna | Rajoni | Punësimi | Përkatësia etnike |
|--------|--|-------|---------------------|---------------------|---------------------|----------------|-------------------|
| M | Shkollë e mesme (Student Bachelor) | 19 | Prishtina/Prishtina | Prishtina/Prishtina | Prishtina/Prishtina | I/e \ punësuar | Shqiptar |
| F | Shkollë e mesme (Student Bachelor) | 19 | Prishtina/Prishtina | Prishtina/Prishtina | Prishtina/Prishtina | I/e papunësuar | Shqiptar |
| M | Mshkollë e mesme (Student Bachelor) | 19 | Vushtrri | Vushtrri | Mitrovica/Mitrovica | I/e papunësuar | Shqiptar |
| F | Shkollë fillore (Nxënës në shkollë të mesme) | 17 | Prishtina/Prishtina | Prishtina/Prishtina | Prishtina/Prishtina | I/e papunësuar | Shqiptar |
| M | Shkollë e mesme (Student Bachelor) | 18 | Prishtina | Prishtina | Prishtina/Prishtina | I/e papunësuar | Shqiptar |
| F | Shkollë fillore (Nxënës në shkollë të mesme) | 17 | Gjilan/Gnjilane | Gjilan/Gnjilane | Gjilan/Gnjilane | I/e papunësuar | Shqiptar |
| M | Shkollë e mesme (Student Bachelor) | 18 | Ferizaj/Uroševac | Ferizaj/Uroševac | Ferizaj/Uroševac | I/e papunësuar | Shqiptar |

Tabela 5. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 2, shqiptarë
Data: 21.11.2020 Ora: 11:00–13:15

| Gjinia | Niveli i arsimit | Mosha | Fshati/Qyteti | Komuna | Rajoni | Punësimi | Përkatësia etnike |
|--------|--|-------|---------------------|---------------------|---------------------|------------------|-------------------|
| F | Bachelor (Master student) | 29 | Prishtina/Prishtina | Prishtina/Prishtina | Prishtina/Prishtina | I/e \ papunësuar | Shqiptar |
| F | Master | 30 | Kacanik | Kacanik | Ferizaj/Uroševac | I/e papunësuar | Shqiptar |
| F | Master | 30 | Prishtina/Prishtina | Prishtina/Prishtina | Prishtina/Prishtina | I/e papunësuar | Shqiptar |
| M | Master | 30 | Prizren | Prizren | Prizren | I/e papunësuar | Shqiptar |
| M | Bachelor | 26 | Gjilan/Gnjilane | Gjilan/Gnjilane | Gjilan/Gnjilane | I/e punësuar | Shqiptar |
| M | Shkollë e mesme (student në nivel Bachelor në dy drejtime) | 27 | Shtime | Shtime | Ferizaj/Uroševac | I/e punësuar | Ashkali |

Tabela 6. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 3, shqiptarë.
Data: 07.12.2020 Ora: 11:00–13:00

| Gjinia | Niveli i arsimit | Mosha | Fshati/Qyteti | Komuna | Rajoni | Punësimi | Përkatësia etnike |
|--------|---------------------------------------|-------|------------------------|------------------------|------------------------|-------------------|-------------------|
| F | Bachelor | 21 | Prishtina/ Priština | Prishtina/ Priština | Prishtina/ Priština | I/e \ punësuar | Shqiptar |
| M | Bachelor | 21 | Gjilan/ Gnjilane | Gjilan/ Gnjilane | Gjilan/ Gnjilane | I/e papunësuar | Shqiptar |
| M | Shkollë e mesme (Student Bachelor) | 22 | Henc | Fushë Kosovë | Prishtina/ Priština | I/e papunësuar | Shqiptar |
| F | Bachelor | 22 | Istog | Istog | Pejë/ Peç | I/e punësuar | Shqiptar |
| M | Shkollë e mesme | 22 | Gurrakoc | Istog | Pejë /Peç | I/e punësuar | Shqiptar |
| F | Bachelor | 22 | Deçan | Gjakova/ Đakovica | Gjakova/ Đakovica | I/e punësuar | Shqiptar |
| F | Bachelor | 25 | Gjakova/ Đakovica | Gjakova/ Đakovica | Gjakova/ Đakovica | I/e punësuar | Egjiptas |

Tabela 7. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 2, shqiptarë
Data: 21.11.2020 Ora: 11:00–13:15

| Gjinia | Niveli i arsimit | Mosha | Fshati/Qyteti | Komuna | Rajoni | Punësimi | Përkatësia etnike |
|--------|------------------|-------|----------------------|----------------------|------------------------|-------------------|-------------------|
| M | Bachelor | 32 | Podujeva | Podujeva | Prishtina/ Priština | I/e \ punësuar | Shqiptar |
| F | Master | 33 | Podujeva | Podujeva | Prishtina/ Priština | I/e punësuar | Shqiptar |
| M | Master | 34 | Gjakova/ Đakovica | Gjakova/ Đakovica | Gjakova/ Đakovica | I/e punësuar | Shqiptar |
| F | Bachelor | 35 | Drenas | Drenas | Prishtina/ Priština | I/e papunësuar | Shqiptar |
| F | Bachelor | 31 | Ponoshec | Gjakova/ | Gjakova/ | I/e punësuar | Shqiptar |

Tabela 8. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 5, serbë
Data: 23.11.2020, Ora: 18:00

| Gjinia | Niveli i arsimit | Mosha | Fshati/Qyteti | Komuna | Rajoni | Punësimi | Përkatësia etnike |
|--------|------------------|-------|----------------|------------------------|-------------------------|-------------------|-------------------|
| F | Bachelor | 25 | Orahovac | Orahovac | Gjakova/ Đakovica | I/e \ punësuar | Serb |
| F | Bachelor | 25 | Banjaska | Zvečan | Mitrovica/ Mitrovica | I/e punësuar | Serb |
| F | Bachelor | 26 | Gracanica | Gracanica | Prishtina/ Priština | I/e punësuar | Serb |
| F | Bachelor | 30 | Ugljare | Prishtina/ Priština | Prishtina/ Priština | I/e punësuar | Serb |
| M | Master | 30 | Sevce | Strpce | Ferizaj/ Uroševac | I/e punësuar | Serb |
| M | Bachelor | 30 | Mitrovica Veri | Mitrovica Veri | Mitrovica/ Mitrovica | I/e punësuar | Serb |

Tabela 9. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 6, serbë
Data: 23.11. 2020, Ora: 20:00

| Gjinia | Niveli i arsimit | Mosha | Fshati/Qyteti | Komuna | Rajoni | Punësimi | Përkatësia etnike |
|--------|--------------------------------|-------|----------------|----------------|-------------------------|-------------------|-------------------|
| M | Bachelor | 23 | Partes | Partes-Pasjane | Gjilan/ Gnjilane | I/e \ punësuar | Serb |
| M | Shkollë e mesme | 25 | Zvecan | Zvecan | Mitrovica/ Mitrovica | I/e punësuar | Serb |
| F | Bachelor | 25 | Lesak | Leposavic | Mitrovica/ Mitrovica | I/e papunësuar | Serb |
| F | Bachelor | 23 | Banjska | Zvecan | Mitrovica/ Mitrovica | I/e papunësuar | Serb |
| F | Student Bachelor | 22 | Strpce | Strpce | Ferizaj/ Uroševac | I/e papunësuar | Serb |
| F | E mesme e ulët e përfunduar | 21 | Mitrovica Veri | Mitrovica Veri | Mitrovica/ Mitrovica | I/e papunësuar | Serb |

Tabela 10. Parametrat për Grupin e Fokusit Nr. 7, serbë
Data:25.11.2020 Ora: 20:00

| Gjinia | Niveli i arsimit | Mosha | Fshati/Qyteti | Komuna | Rajoni | Punësimi | Përkatësia etnike |
|--------|-------------------|-------|----------------|----------------|-------------------------|---------------------|-------------------|
| F | E mesme e ulët | 18 | Ranilug | Ranilug | Gjilan/ Gnjilane | I/e \ papunësuar | Serb |
| F | Student Bachelor | 18 | Mitrovica Veri | Mitrovica Veri | Mitrovica/ Mitrovica | I/e papunësuar | Serb |
| F | Student Bachelor | 19 | Gracanica | Gracanica | Pristina/ Priština | I/e papunësuar | Serb |
| M | Student Bachelor | 19 | Strpce | Strpce | Ferizaj/ Uroševac | I/e punësuar | Serb |
| F | Nxënës në gjimnaz | 16 | Zvecan | Zvecan | Mitrovica/ Mitrovica | I/e papunësuar | Serb |
| M | Student Bachelor | 19 | Mitrovica Veri | Mitrovica Veri | Mitrovica/ Mitrovica | I/e punësuar | Serb |

Sfidat dhe këndvështrimet e të rinjve në Kosovë


**Studimi është
kontraktuar UNDP
në Kosovë**

Prishtinë
Janar 2021

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të pjesëmarrësve të anketës dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e UNDP-së



UNITED NATIONS
KOSOVO TEAM



SUSTAINABLE
DEVELOPMENT
GOALS



United Nations
Peacebuilding